Aga Hani i katërt i sotëm, Kerim El-Huseini, tanimë në moshësh gjashtëdhjetëvjeç, posedon aeroplanin e vet dhe shumë mercedesë, ndërsa pasuria e tij vlerësohet në 500 milion funti sterlinë. Rreth pesë milionë ithtarë të tij përveç në Indi jetojnë edhe në Afganistan, Pakistan, Jemen, Siri dhe në Afrikë. Ismailinjtë e konsiderojnë veten më të fuqishëm se myslimanët e tjerë dhe të ndryshëm nga ata. Në qendrat e tyre tubohen të premtëve dhe lexojnë letrën e Aga Hanit. Në secilën seancë të tyre mbledhen të hollat dhe i dërgohen Agait. Gjithashtu çdo ismaili t'i paguajë atij një të tetën e t'ardhurave të veta vjetore (dasong). Agai shpeshherë u thotë se “dasingu është themeli i fesë”. Në vitin 1975 disa ismailinjtë në Portugali, të cilët jetonin nga ndihma sociale, pasi që misionarëve ismailijë i kanë obliguar që edhe ata të paguajnë një të tetën e vet, ndërmorën kryengritje. Këto të holla përdoren që kurrnjë ismailij në botë mos të jetë i pasiguar.

E nëna e Agait të fundit është angleze, si dhe bashkëshortja e tij, kurse e babit (gjyshja) italijane.

FOTOGRAFI (faqe 38). *Aga Hani III bëhet imam i isnailinje në moshën tetëvjeçare - Perëndia paraparak (babai i*

KUSH JANË SHIINJTË?

të sotmit) e ka dashur Francën më tepër se Indinë - Perendia i personifikuar i sotëm - Aga Hani i Iv

Prej degëve shiinj të cilët ende ekzistojnë tanimë janë përmendur **nusarinjtë (alevinjtë)**, në pushtet në Siri dhe një pjesë e vogël në Turqi.

Druzët, të cilët i përmendëm në lidhje me ismailinjtë, posedojnë territorin e vet në Liban, kurse ata që jetojnë në Izrael shërbejnë në ushtrinë izraelite.

Iniciator i fesë së tyre ishte Hamza b. Ali, persian. Ata besojnë se Zoti është mishërua në figurën e prijësit fatimij El-Hakimit. Sipas tyre Zoti mishërohet kurdoherë që njerëzia ka nevojë për shpallje të re, dhe të përgatiten ithtarët për pejgamber të ri, e që sipas tyre është Hamza Persiani i përmendur. E, duke qenë se çdo pejgamber e tejkalon atë që ka qenë para tij, kështu Hamza dhe feja e tij janë plotësues të Islamit. Druzët besojnë në dyndjen e shpirtërave pas vdekjes nga trupi në trup, andaj nuk pranojnë ithtarë të rinj në fenë e tyre, pasi që të gjithë shpirtërat tanimë kanë jetuar qysh në kohën e Hamzës. Pas shpalljes së fesë së tyre, të gjithë ata që nuk e kanë pranuar atë janë të obliguar të paguajnë xhixjen! (tatim që sipas dispozitave islame u është caktuar të krishterëve dhe hebrenjve).

Hamza me këtë fe të re të tij në realitet ua ka hapur dyert pasardhësve jofatimij që të bëhen imam. Sikur të ishte Hamza imam, atëherë pas tij imam do të ishte djali i tij; kështu, duke e shpallur atë për zot, ai ka mundur ta shpallë veten vetëm si pejgamber.

Përndryshe druzët e ndajnë vetën në “të arsyeshëm” (mbi 40 vjeç), të cilët munden të prezentojnë leximit dhe studimit të

domethenieve të fshehta të librave të tyre fetare, dhe në “të paarsyeshëm” (nën 40 vjeç), të cilëve nuk u lexohen domethëniet e fshehta. Për jo-druzët hyrja është e ndaluar. Të gjithë druzët janë vëllezër. Babai i tyre është Drita e cila është Arsyēja, kurse nëna e tyre është Mëshira, e cila është Fryma Universale. Gjithsej janë rreth gjysmë milion njerëz që jetojnë në Liban, në Siri dhe në Izrael.

FOTOGRAFI (faqe 40). *Varri druzian*

Ali-ilahinjte besojnë në hyjninë e Aliut, ndërsa *bektashinjte* trininë All-llahu - Aliu - Muhammedi, qendra e të cilëve është Shqipëria (!), ku para komunizmit përbënin 10% të popullatës, por ka sish edhe në Kosovë. I përmbahen dymbëdhjetë imamëve të njejtë sikurse edhe shiinjte “dymbëdhjetëshit”, kurse predikojnë barazinë e të gjitha feve (sikurse shehu sufij Ibni Arebiu). Ritualit i pranimit të anëtarëve të rinj përbëhet nga pirja e verës bri bukës dhe djathit, rrëfihen, ndërsa kryerjen e obligimeve fetare e konsiderojnë si hipokrizi. Ceremonia e posaçme i është dedikuar sufiut Halaxhit, të cilit iu është prerë koka për shkak herezës. Sot mbrojtës i beshktashinjve në Shqipëri është natyrisht - Irani, i cili nuk i harron kusherirët e vet për nga feja, qoftë fjalë për bektashinjte në Shqipëri, Nusajrinjtë në Siri, Ismailinjte në Jemen apo dervishët në tërë botën. Është interesant se si bektashinjte e kanë zgjedhur mu Shqipërinë për qendër të vet. Njeriu i parë i cili ka futur ligje dhe zakone të evropës në shtetin osman në shekullin 19, Mid’had-pasha ka qenë bektashi. Pas ardhjes së “turqëve të rinj” bektashinjte nga turqia kanë bërë hixhret në Shqipëri. Në Shqipëri ndarjet fetare janë lidhur ngusht sipas

fiseve. Gegët janë myslimanë apo katolikë, ndërsa toskët janë ose myslimanë, ose bektashijë ose ortodoks.

FOTOGRAFI (faqe 41) *Udhëheqësia botërore e bektashinjve gjendet në Shqipëri!*

Sufinjtë (dervishët) i kanë përvetësuar besimet shiite dhe i kanë adaptuar masave myslimane, duke shtuar besimin në “beregët” që është prezent gjithkund në botë nëpër vende lidhur me “evliatë”. U është i përbashkët besimi në ndërmjetësimin e “evliave” tek All-llahu, prandaj, sikurse edhe shiinjtë, i vizitojnë tyrbet. Krahës kësaj kanë futur edhe shumë risira në fe, siç është dhikri i përbashkët i cili duhet t’i sjell në trans, ku “shpirti do t’i kthehet burimit fillimor”. Në kësi ideje hasim edhe te neoplatonizmi, treqind vjet para paraqitjes së Islamit, siç hasim edhe idetë të tjera shiite-sufiste mbi “Njeriun e Përsosur”, “Strumbullarët e Gjithësisë” (kutiub) dhe “Dituria e fshehur” te zoroastrizmi i Persisë së vjetër. Disa shehlerë sufijë kanë qenë iniciatorë të feve të reja, sikurse **sikhizmi**, në të cilën iniciatori i saj Guru Nanaku është përpjekur që nga Islami dhe hinduizmi të bëjë një fe të re të përbashkët, duke marrë nga Islami monoteizmin dhe mbulesën e femrave.

FOTOGRAFI (faqe 42) *“Shehu sufij shpallet peygamber i ri dhe themelon një fenë e re - sikhizmin”.*

Apo sikurse **jezidizmi** i cili rrjedh nga shehu sufij Adij b. Musafirit.

Ka qenë nxënës i Gazaliut (një ndër emrat më të mëdhenj sufij) dhe vendoset te kurdët, ku i vinin, gjatë jetës së tij dhe pas vdekjes së tij, pelegrinët nga e tërë bota. Ndër shenjtoret e tyre është edhe njëra kushtuar një emri të madh sufij Abdulkadër Xhejlaniut (sipas të cilit është quajtur “Tarikati

kaderij”) dhe tjetra kushtuar shehut sufij Hallaxhiut, të cilin tanimë e kemi përmendur lidhur me bektashinjtë, dhe i cili sikurse edhe jezdinjtë doktrinonte se Zoti ia ka falur Iblisit. Për shkak të respektimit të tyre të djallit, i cili sipas mësimit të tyre, e ka krijuar botën, kurse Zoti e ka krijuar vetëm njeriun (marrë nga manihenjtë (bogumilët), kanë mbrojtje speciale të djallit. Ata nuk e quajnë djall, por “engjëll pallua”, e nëse dikush e mallkon djallin para tyre, e sulmojnë aty për aty. Sipas besimit të tyre sheh Adijji i ka marrë mbi vete obligimet e tyre të namazit dhe të agjërimit, kur në Ditën e gjykimit ata do të ngriten në qiell pa u gjykuar. Në ceremonitë e veta misterioze, prijësit e tyre kërkojnë kësajllë nga Iblisi. Ithtarëve të tyre u është ndaluar çdo libër, kurse mësimi i tyre gjendet në librin “Xhevla” (shpallja), të cilin e ka diktuar shehu Adijj para vdekjes së tij, dhe në komentarin e tij që quhet “Libri i zi”, e të cilin e ka përpiluar stërnipi i shehut, Hasani.

FOTOGRAFI (faqe 44) *Tyrbja e jezidinjeve - Jezidinjtë*

Disa grupacione renegate, janë formuar pavarësisht nga shijnjtë shë sufinjtë. Kah fundi i shekullit 19 paraqitet në Indi personaliteti i Mirza Ahmedit, i cili vetëshpallet si Mehdiu i ri dhe si vetë Isai a.s.! Ithtarët e tij quhen **ahmedijë**, për të cilët ka shkruar edhe Kasim Dobraça pas kthimit nga Az'hari, viteveve tridhjetë të këtij shekulli. Resulull-llahu s.a.v.s. na ka informuar për ardhjen e Isait a.s. në kohën e paraqitjes së Dexhxhallit, kur së bashku me ushtrinë myslimane të cilën do ta paraprijë Mehdiu do ta ngadhënjejë Dexhxhallin dhe ushtrinë e tij. Isai do ta thyej kryqin e të krishterët do ta pranojnë islamin dhe do ta ndërprejë xhizjen, duke qenë se më nuk do të ketë jomyslimanë. Mirza Ahmed, duke e quajtur

veten Mehdi dhe Isa njëkohësisht e ka ndërprerë xhihadin duke u thirrur në ndërprerjen e xhizjes, ndërsa thyerjen e kryqit e ka shpjeguar si zgjerim të Islamit në shtetet krishtere. Në të vërtetë ahmedijët kanë qenë të parët që kanë formuar qendra nëpër botë. Për ta argumentuar “mehdillëkun” e vet, Mirza është shërbyer me mjete të njëjta me të cilat shërbehen sektet e reneguara nga Islami - komentimin arbitrar të Kur’ani dhe të Hadithit. Resulull-llahu s.a.v.s. për shembull ka thënë se Isai a.s. do të zbresë në “mineren e bardhë lindor” në Damask. (Minaren mund ta shihni në anën lindore të xhamisë umejite në Damask). Mireza komenton se Isai a.s. (d.m.th. Mirza personalisht) do të vijë nga lindja (nga India)!! Ndërprerja e xhihadit tregon në mundësinë se Britania e Madhe (e cila asokohe sindonte në Indi dhe të cilës i konvenonte ndërprerja e xhihadit), ka qenë prapa paraqitjes së ahmedijëve.

FOTOGRAFI (faqe 46) *“Mirza Gulam Ahmedi është shpallur njëkohësisht për Mehdiun dhe Isain a.s.” - “Kalifi” i sotën i ahmedijëve.*

Nuk është Mirza i vetmi i cili është shpallur për Mehdiun. Pasardhësit dhe pasuesit e të vetquajturve “Mehdijë” sudanez kah fundi i shekullit XIX por edhe sot luajnë rol të rëndësishëm në Sudan.

Viteve tridhjetë të këtij shekulli është paraqitur një fe e re në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me emrin **“Myslimanët e zinj”**. Të gjithë së bashku i gëzoheshim fitoreve të Muahmed Aliut, apo në kohët më të reja të Majkl Tajsonit, duke pandehur se janë bashkëbesimtarët tanë. Mirëpo feja e tyre dallon qenësisht. Paraardhës i “Myslimanëve të zinj” ka qenë “Tempulli shkencor maurian” i themeluar në vitin 1913 nga

KUSH JANË SHIJNJTË?

ana e Timoti Druasë, i cili është quajtur pejgamber me emrin Ali, dhe i thërriste zezakët që t'i kthehen Islamit i cili do t'i lironte nga shtypja raciale. Markus Greji në vitin 1914 i ka vënë parimet e lirit të zezakëve, të cilat gjithashtu kanë pasur tipare raciale, por kësaj radhe kundër të bardhëve, dhe të cilat do t'i përvetësojnë “Myslimanët e zinj”. Themelues i “Myslimanëve të zinj ka qenë Veli Faradi, i cili ka emigruar në Amerikë në vitin 1930, dhe një vit më vonë themelon tempullin në Detroit. Pasuesit e tij kanë qenë banorët e zinj qytetarë të cilët besonin se Faradi është Zoti i mishëruar, që kishte ta lirojë, si e quante ai “kombin e fundit islam të gjetur në Perëndim”. Ky është emri i tyre zyrtar edhe sot “Kombi Islam”. Faradi u kishte premtuar se do t'i ngadhënjë zotërinjtë e tyre të bardhë, po që se ndjekin doktrinën e tij dhe bëhen të vetëdijshëm për të vërtetën mbi veten e tyre. Në vitin 1934 Faradi zhduket në mënyrë misterioze, me siguri i oersekutuar. Këtë e trashëgon Eljas Muhammedi (i cili më parë quhej Robert Pol), dhe themelon tempullin e dytë në Çikago. Pas Luftës së Dytë Botërore, tanimë çdo qytet më i madh në Amerikë kishte mesxhidin e “Myslimanëve të zinj”. Nën udhëheqjen e Eljas Muhammedit, doktrina e tyre ishte që Islami të propagojë superioritetin moral dhe kulturor të njeriut të zi, të cilin All-llahu e ka paracaktuar të sundojë me botën. Njeriu i zi është i thirrur që të përgatitet për qësrim e fundit të hesapeve ndërmjet të mirës e të keqes. Raca e bardhë është kategorizuar si djallëzore, periudha e së cilës është në mbarim e sipër.

Në këtë mënyrë Eljas Muhammedi është përpjekur që me këtë fe qesharake tua rikthejë vetëbesimin njerëzve të shtypur

KUSH JANË SHIJNTË?

shekuj me radhë në Amerikë. Mirëpo, kohe doemos është dashur të shpie në ndryshime. Zëdhënësi i tij Malkolm X., pas kryerjes së haxhxit në Mekë dhe pas takimit me mbretin Fejsal, kupton se Islami nuk e njeh racizmin, dhe menjëherë pas kthyerjes fillon të thërrasë në Islamin e vërtetë, duke formuar një grup rival me emrin “Zhanian myslimane”. Në vitin 1965 në të bëhet një atentat. Mirëpo, vetë djali i Eljas Muhammedit, Uarisuddini, i cili ka studiuar në Az’har dhe bëhet trashëgimtar i babait të vet pas vdekjes së tij në vitin 1975, kupton herezën e doktrinës së babait, dhe gjatë dhjetë viteve shkon për dore që gradualisht ta kthejë organizatën kah Islami burimor, duke e quajtur në vitin 1985 “Bashkësia Botërore Islame e Perëndimit”, duke ua hapur mesxhidet e veta të gjitha racave. Ata që nuk që nuk i pranuan këto ndërrime, e mbajtën emrin e vjetër “Kombi Islam” (Myslimanët e zinj) nën udhëheqjen e Luis Ferhanit, i cili në vitin 1996 ndërmer veprime të rëndësishme propagandistike, siç është “tubimi i një milion meshkujsh të zinj”, që dukshëm i ka shkundulluar marrëdhëniet raciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pastaj viziton Irakun dhe Libinë dhe i përkrahë diktatorët e atyshëm, ndërsa në Iran i bashkangjitet sharjeve të “Djallit të Madh”.

Këta edhe më tej bëjnë që të kalojnë në anën e tyre pasues të ri, të tërhiqur me instruksione racore, mirëpo, si kam dëgjuar nga miqtë e atjeshëm, shumica e këtyre pasuesve me kohë i bashkohen grupit sunnit. Një gjë e ngjashme u ndodhë edhe njerëzve perëndimor, të cilët zakonisht e përqafojnë Islamin të joshur me mistikën e sufijnjë, që pastaj me kohë të njoftohen me fenë burimore e të bëhen sunninj.

FOTOGRAFI (faqe 50) - *Malkolm X. bisedon me kralin Fejsal. Pas kësaj vizite të Arabisë dhe kryerjes së haxhxit Malkolm X. i kthehet Islamit burimor. - Çka nuk i ka pëlqyer “Kombit Islam” - “Kombi Islam” dhe lideri i madh i tij Luis Farahan*

Më në fund, para se t'i kthehemi shiinjve, të përmendim edhe një grup, të vjetër sa edhe vetë shiinjët, e cila sot dominon në Oman dhe e cila në vitin 1994 ndërmori persekutime të mëdha të Ehli-Sunnetit. Këta janë **havarixhinjtë (harixhinjtë)**, të cilët gjithashtu kanë pasur shume grupacione, ndërsa grupi që ka mbetur gjer më sot quhet **ibadinjtë**. Ajo sipas së cilës dallohen nga Ehli-Sunneti është para së gjithash besimi se kryesi i mëkatit të madh mbetet përgjithmonë në Xhehennem, kurse hadithin e Resulull-llahut s.a.v.s. (**teksti arabisht**) “Kush thotë: “Nuk ka zot përveç All-llahut, do të hyjë në Xhennet, madje edhe nëse ka bërë zinallëk (prostitucion), madje edhe nëse ka vjedhur”, e komentojnë se ka të bëjë me atë që pendohet (!), ndërsa hadithin (**teksti arab**) “Kush vdes duke mos i bërë asgjë shok All-llahut do të hyjë në Xhennet”, e komentojnë “nëse vdes pa bërë mëkatel!”

Fakti se mëkatarin e madh e vendojnë përgjithmonë në Xhehennem nënkupton se atë e konsiderojnë jobesimtar, si dhe çdonjërin që këtë nuk e konsideron jobesimtar. Për këtë arsye lehti e ngrisin dorën kundër myslimanëve dhe derdhin gjakun e tyre që ka ngjarë gjatë tërë historisë së Islamit. Dhe, jo vetëm që derdhin gjak, porse sulen edhe në nderin e sunninjve, duke konsideruar se kanë punë me jobësimitarë (po kështu veprojnë edhe shiinjët).

KUSH JANË SHIINJTË?

Hdithin e Resulull-llahut s.a.v.s. **(teksti arab)** “*Kush ngre armët kundër nesh, nuk është prej nesh*” e komentojnë në mënyrë edhe më qesharake, e thonë: “d.m.th. kush dërgon armë në vendin e armikut” (!!)

Të gjitha këto janë komentime të përkundërta dhe komentimet e shehlerëve të tyre të sotëm, siç janë Haliliu, Smailiu, Sijabiu, që tregojnë se edhe më tej i përmbahen fesë së harixhinjve. Veten e quajnë “Pjesëtarë të vërtetës dhe të rrugës së drejtë”, kurse Ehli Sunnetin e akuzojnë se e proklamojnë njëri-tjetrin jobesimtar nëse i takojnë shkollave të ndryshme juridike (të fikhut)!!

Nga **mu'tezilinjtë** (të cilët sot nuk ekzistojnë më si grup) kanë përvetësuar (sikurse edhe shiinjtë) mohimin e Cilësive të Zotit, andaj duke qenë se mohojnë të folmen e Zotit konsiderojnë se Kur'ani është i krijuar. Po ashtu mohojnë pamjen e All-llahut në ahiret (sikurse edhe shiinjtë). Kur myftiu i njohur Ibni Bazi pat thanë se nuk mund të falet pas atij që mohon pamjen e All-llahut në ahiret (edhe përkundër ajeteve dhe haditheve që flasin lidhur me këtë), këta reagueshan ashpërsisht.

Nga qështjet tjera sipas së cilave dallohen nga Ehli Sunneti, bën pjesë edhe lejimi i bërjës së kryengritjes kundër sundimtarit të padrejtë, edhe përkundër asaj se ai e praktikon fenë, në të kundërtën e fjalëve të Resulull-llahut s.a.v.s., i cili kur qe i pyetur nga as'habët a do të ngriten kundër sundimtarëve zullumqarë, ka thënë: **(teksti arab)** “*Jo, përderisa ai e praktikon fenë*”. Gjthashtu harixhinjtë nuk ua njohin të drejtat kurejshëve për udhëheqjen e ummetit

(bashkësisë) islam, në të kundërtën e fjalëve të Resulull-llahut s.a.v.s.: **(teksti arab)** “*Udhëheqësit janë nga kurejshët*”.

Në kohën bashkëkohore aty-këtu paraqiten grupe të vogla me mësimet e tyre lidhur me proklamimin e myslimanëve jobesimtarë, siç është grupi “Tekfir ve Hixhra”. Havarixhët nuk i përfillin hadithet e Resulull-llahut s.a.v.s., edhe pse nuk janë të njohur me trillimin e haditheve të cilat ia vënë Resulull-llahut s.a.v.s. në gojë, siç është rasti te shijnjtë. Nga personalitetët e njohur, që e kanë mohuar rëndësinë e hadfitheve të Resulull-llahut s.a.v.s. në kohën tonë është lideri Libian Mu’ammer Gadafi (Kazzasafi).

FOTOGRAFI (faqe 53) - *Rajonet në botë në të cilat Ehli Sunneti është në pushtet*

HISTORIA DHE DOGMA E SHIIZMIT

Më vonë do të shohim se feja shiite nuk është asgjë tjetër pos zoroastrianizmi persian paraislamik me primesa të neoplatonizmit grek dhe maniheizmit persian, e mbështjellur me veshje të jashtme të pasimit së pasardhësve të Aliut. Mirëpo, këto sisteme të ndërlikuara dhe të zbrazëta, në të cilin kemi hasur edhe më parë në historinë e krishterimit (të shtrembëruar), janë të panjohura për masat shiite. Vetëm elita, hoxhallarët (fjalë persiane) të niveleve të ndryshme (“ajetullahët”, “haxhxhetul-islamët” etj.), të cilët posedijnë status pozitë të shuguruar në shoqërinë shiite (dhe jetojnë në mënyrë të këndshme duke i falënderuar tagrave, që paguajnë besimtarët), janë ata prej të cilëve pritet që të flasën sa më ndërlikueshëm, në mënyrë që sa më pakë të kuptohen, dhe kështu t’i lënë masan me ndjenja frikërespekti të thellë. Kjo është gjithnjë recetë e njëjtë, e cila përherë ka sukses gjithkund në butë, e jo vetëm te shiinjtë, por edhe te dervishët, hindusët, budistët, të krishterët etj., me “misteritë” e veta, të cilat mund të kuptohen vetëm në botën tjetër... Falënderimi i qoftë All-llahut për fenë tonë të bukur të arsyes, e cila nuk njeh klerizëm e as ndonjë ndërmjetësues ndërmjet robit dhe Krujesit!

E, përse i përket masave shiite, feja e tyre më së shumti i gjason katolicizmit apo ortodoksisë, hinduizmit apo shintoizmit. Kjo është fe e të shenjtërve dhe e ikonave, tyrbeve dhe besëtytnive. Një ngjarje që ka ndodhur më njëzet korrik të vitit 1991 tregon tërë thellësinë e besëtytnisë së tyre. Radio Pekini në persishte sjell parashikimin e astrologut kinez Sung i Bia , i cili ndërmjet yjeve kishte “lexuar” se mu atë natë Teheranin do ta godasë një tërmet. Edhe pse radio Teherani e përcjell lajmin duke shtuar se seizmologët nuk kanë gjetur kurrfarë shenjash për ndonjë tërmet të mundshëm, i tërë Teherani doli jashtë shtëpive, kurse nëpër rrugë mbretëronte rrëmujë e paparë automobilësh, që tentonin të ikin nga qyteti.

FOTOGRAFI (faqe 55) - *Iranianët ikin nga Teherani pasi që astrologu ka profetizuar tërmetin.*

FOTOGRAFI (faqe 56) - *“O Ali, më shpëto!” - “Thirre Aliun, bërësin e çudirave, do ta gjesh si ndihmës në vështirësira. Do të të kalojë çdo brengë për furnizimin tënd, o Ali, o Ali!” - “Kërkoj ndihmë nga All-llahu, Muhammedi dhe Aliu!” - Hajmalitë shiite*

Edhe Homeini i është paraqitur popullit të thjeshtë si shembëllesë e vetë “martirit nga Kerbeleja”, Huseinit, djalit të Aliut. Në moshën njëvjeçare ia mbytën babën. Kjo ndodhi rreth vitit 1900. Ndër popull përhapet lajmi kinse e kishte vlarë njëfarë agjenti i Shah Pahlevit (kurse Shahu ka ardhur në pushtet në vitin 1920).

Për Homeinin populli flet se ka bërë parashikime dhe çudira, e ajo që është marrë me sufizëm dhe e ligjëronte atë për popullin don të thoshte se është në gjendje të kontrollojë komentimin e rrezikshëm figurativ të Kur’anit, e posaçërisht

KUSH JANË SHIINJTË?

ngase ky ruhej nga humori, për dallim nga “ajatullëhet” e tjerë, të cilët me humor përfitonin pasues.

Me urdhrin e Homeinit janë këthyer në rrugët e Teheranit ceremonitë shiite të vajtimit për huseinin gjatë muajit muharrem.

Por kjo gjithashtu është edhe besimi në urrejtjen e madhe ndaj “navasibët” (rrëmbyesit), siç na quajnë ne, Ehli Sunnetin, ngase konsiderojnë se tre kalifët e parë ia kanë rrëmbyer të drejtën kalifit Ali për ta trashëguar Resulull-llahun s.a.v.s. e të jetë në krye të shtetit pas vdekjes së tij. Sipas dijetarit shiit Tekizades, feja shiite i ka dhjetë rukne:

1. agjërimi,
2. namazi,
3. haxhxi,
4. xhihadi,
5. një e pesta e tardhurave i jipet hoxhallarëve,
6. zekati,
7. urdhëri për të mirë,
8. pengesa e të keqes,
9. dashuria ndaj familjes së Aliut,
10. urrejtja ndaj armiqëve të tij (d.m.th. ndaj Ehli Sunnetit).

FOTOGRAFI (faqe 57) - ...*sharti i dhjetë i “Islamit” - dashuria ndaj familjes së Aliut. I dhjeti - urrejtja ndaj armiqëve të tij...*

Ndërsa ulemaja islame shiinjte i quan “rafidinjë” (refuzues). Prejardhja e këtij emri është e lidhur me kryengritjen të cilën e ka ydhëhequr stërnipi i Aliut Zejdi, kundër sunduesit që e konsideronte si jo të drejtë. Shiinjte kanë

KUSH JANË SHIJTË?

refuzuar ta përkrahin, ngase nuk kishte dashur t'i shante tre kalifët e parë. Prej atëher janë quajtur “refuzues” (arabisht “rafida” apo “ravafida”). Emri i shijnjve (parti) në realitet ka të bajë me ata myslimanë të cilët ishin me Aliun në konfliktin me Muaviun, i do të bëhet kalif pas vdekjes së Aliut. Për këtë konflikt do të bëhet fjalë më vonë. Disa myslimanë konsideronin se Muaviu ka të drejtë, disa të tjerë konsideronin se Aliu ka të drejtë, kurse të tjerët mbetën jashtë konfliktit. Megjithatë, të gjithë kanë mbetur në të njëjtën fe, duke mos futur risira deh pas vdekjes së Aliut konflikti zgjidhet. Mirëpo disa popuj posa të ngadhënjyer, veçanërisht persianët dhe hebrenjtë, vazhduan me makinacione dhe tentime për shkatërrimin e shtetit islam në mënyrë që përsëri të lindin besimet e vjetra paraislamike. Por, shteti ishte tejet i fuqishëm për ta bërë këtë haptazi. Prandaj qenë të detyrar të vepronin pas perdes në kërkimin e të drejtës së dikujt të cilit i ishte bërë e padrejtë, në mënyrë që të gjenin mbështetje nga masat e paarsimuara e posa të islamizuara. Këta fshiheshin pas të drejtës të pasardhësve të kalifit të katërt Aliut që t'i udhëheqin myslimanët, edhe pse kët nuk e kishte kërkuar prej tyre, e as që dikush nga pasardhësit e Aliut e ka ndërruar fenë e vet. Për këtë shkak të gjithë këta ngatërrestarë nuk gjetën mbështetje, pos nga mesi i persianëve, hindusëve, mongolëve dhe ndër disa fise beduine (nomade) të padijshme arabe. Duke i vënë në gojë çka u binte ndër mend pasardhësve të Aliut, si dhe vetë Aliut, madje edhe vetë Resulull-llahut s.a.v.s., dhe krahas mësimi se çdo ajet kur'anor posedon domethënien e vet të jashtme dhe të brendshme e të fshehtë, të cilën e dinë vetëm të zgjedhurit, kanë mundur këta komplotistë që nga hiri ta ngjallin fenë e

KUSH JANË SHIINJTË?

vetë të mposhtur nën veshjen e “Islamit qenësor”, të cilin, sipas gënjeshtreve të paturpshme të tyre, Resulull-llahu s.a.v.s. i ka treguar vetëm Aliut, e ky më tej ua ka përcjellur pasardhësve të vet, kurse myslimanëve të tjerë u është shpallur vetëm “Islami i jashtëm”. Natyrisht, rafavidët, të cilët e quajtën veten shiinj (“Shi’atu Ali” - partia e Aliut) për t’i fshehur qëllimet e veta të vërteta, kanë qenë të ndjekur gjatë tërë historisë islame si përçarës të rrezikshëm, kurse ulemaja e tyre e likuiduar për shkak të rrezikshmërisë që paraqisnin për fenë, dhe varroseshen jashtë varrazave myslimane. Fetvaja e shejhil Islamit në kohën e sultanit osman Selimit I, në të cilën kishte urdhëruar që çdo shiit të mbytet, obligon që me ta të veprohet sikurse me cilindo armik të myslimanëve në luftë dhe se gratë dhe fëmijët e tyre mund të mirren si robër. Këtyre nuk u është lejuar të marrin pjesë në ushtrinë myslimane.

Mongolët, të cilët i kishin shfarosur krahinat e Perandorisë Abasite, sipas nxitjes të dijetarit rafidin Nasiruddin Tusiut (për të cilin Homeini thotë se i ka kontribuar shumë Islamit), janë lëshuar në Bagdad, kryeqendrën e kalifatit, me tradhtinë e vezirit rafidij Ibni Alkames. Në masakrin e tmershëm që ndodhi atëbotë, u kursyen vetëm pjesëtarët e fesë së tij. Më vonë edhe vetë mongolët e pranojnë fenë e tyre dhe bashkëpunojnë me kryqëtarët në luftu kundër Ehli Sunnetit. Shpëtimi i ri erdhi në formë të fuqisë së re të Ehli Sunnetit osmanlinjtë. Mirëpo, atëherë rafidinjtë (dymbëdhketëimaminjtë) fitojnë shtetin e vet në Iran, ku përfundimisht e marrin pushtetin në vitin 1502 dhe mbeten armiqë kryesorë të Perandorisë Osmane. Madje u ndihmojnë

KUSH JANË SHIINJTË?

edhe holandezëve që ta nënshtrojnë shtetin Jaaribik në bregun lindor të Siujdhesës Arabike.

Shekulli njëzet bëhet dëshmitar i ndërprerjes së Perandorisë Osmane dhe të kalifit të të gjithë myslimanëve të botës. Rafidinjve u jipet rasti që përsëri të tentojnë t'i vardisen botës myslimane në mënyrë që t'i kthejnë në fenë e tyre. Vetën e shpallin si një nga shkollat juridike, të pestën - Xhaferite, krahas katër ekzistuese - Hanefite, Shafi'ite, Malikite dhe Hambelite. Duke përdorur presionin me kohë u shkon për dore që Arabia Saudite t'ua lejon kryerjen e haxhxit dhe të umres, edhe pse Abdul Azizi, themelues i Mbretërisë Saudite nuk ua patë lejuar këtë. Irani edhe sot paraqet rezik real, mirëpo ushtria saudite është e armatosur mirë. Shtetet e tjera të Ehli Sunnetit, si Egjipti, Turqia apo Pakistani posedojnë fuqi të mëdha ushtarake, dhe është për t'u besuar se nuk do të lejonin që Meka dhe Medina të jenë të zaptuara nga ana e rafidinjve. Prandaj Irani me shpejtësi është duke u armatosur dhe sipas të gjitha gjasave do ta shfrytëzojë shpartallimin e ushtrisë irakiane pas Luftës së Gjirit që përsëri të tentojë ta marrë nga sunninjtë pjesën jugore të Irakut që është e popullsuar kryesisht me shiinj. Nga Rusia janë furnizuar me armatim modern, ndërsa teknikët nukler rus punojnë në ndërtimin e centraleve atomike. Ekspertët perëndimorë konsiderojnë se Irani gjer në vitin 2.000 do të mund të mbarojë bombën atomike. Bashkëpunimi nuklear është ndërlidhur edhe me Indinë. Është tërësisht e kuptueshme se Irani do të kërkojë aleatë nëk india kundër Pakistanit sunnit, siç ka gjetur aleat te Rusia kundër Azisë së Mesme dhe turqisë. Selia e qëndrës hulumtuese nukleare gjendet në Nekë - vend në Iranin Verior, të fshehur në

bjeshkë, ndërsa në bashkëpunim me Rusinë punon duke shpejtuar në zhvillimin e armëve biologjike (bomba të mbushura me shpërndarësit e sëmundjeve të ndryshme).

FOTOGRAFI (faqe 61) - *Homeini ka lënë me testament që të forcohet lidhja me Rusinë. Dhe, me të vërtetë, Irani është furnizuar me armatim më modern rus, me nëndetëse nukleare, me centrale nukleare dhe me 60 mijë ekspertë nuklear.*

Irani vihet edhe si mbrojtës i pakicës rafidinsh në Pakistan (15% të popullatës), Afganistan (10%), Bahrejn (50), Libanm (30%), Kuvajt, Arabonë Saudite, por njëkohësisht dëshiron që t'u jetë edhe si udhëheqës shpirtëror. Në kohën kur jam duke e përpiluar këtë broshurë (1995), Irani tenton që ta vënë persianin Hamanein për udhëheqës suprem shpirtëror të rafidinjeve në botë, ndërsa kësaj i kundërvihen bashkëfetarët e tyre nga Iraku dhe Libani. Për sa i përket vendeve të Ehli Sunnetit, Irani përpiket që të prezentohet si mik i tyre, krahas ndihmesës materiale vendeve të varfëra, ku është duke ndërtuar spitale dhe shkolla, e tërë kjo me qëllim që t'i vendos bazat për zgjerimin e fesë së vet. Në të njëjtën mënyrë ka vepruar edhe shteti fatimij, duke dërguar fepërhapësit në të gjitha anët e botës myslimane, ku së pari zgjeronin fenë në mes të papullatës së paarsimuar, e pastaj nxitnin kryengritje.

FOTOGRAFI (faqe 62) - *Celula e mercenarëve iranian në Egjipt, e cila ka qenë e ngarkuar për sabotime*

Metoda me të cilën shërbeheshin për për t'i bërë njerëzit që ta pranojnë fenë e tyre, ishte të mbjellin dyshime në atë që besonin ata, e pastaj u ofronin besimin e vet. Në Sudan, ku dervishët (sufinjtë) kanë autoritet dhe ndikim të madh, iranianët janë bashkuar me ta në "Shoqata e Ehli Bejt"'

(familja e Resulull-llahut s.a.v.s. , përkatësisht e Aliut). Më kujtohet se si edhe dervishët tanë, gjatë revolucionit në Iran, brohoritnin : “Të gjithë ne jemi shiinjtë!” Dhe, me të vërtetë, nëse i hedhim një vështrim librave të dervishëve tanë, do të gjejmë renditjen e njëjte rafidije të dymbëdhjetë imamëve të “pagabuar”, prej të cilëve përfitohet, përmes shumë shehlerëve dervishësh”dituria e fshehtë”. Alimi i njohur rafidij Sejjid Hajdar Amuli, në librin e vet “Xhamiul esrar” (Përmbledhja e fshehtësive) dëshmon se shiizmi dhe sufizmi janë një. Në kohën e sundimtarëve të fuqishëm shefat e shiinjve likuidoheshin, siç ka ndodhur me Shemsudin Muhammedin (Damask, në vitin 786/1384), me Zejnud-din b. Aliun (Stamboll, në vitin 996/1558) apo me Kadi Nurullahun (Indi, në vitin 1019/1610).

Edhe shehlerët dervishësh kanë qenë të ndjekur, që nga koha e Mutevekilit, kalifit abasid në gjysmën e parë të shekull të tretë hixhrij, e pas vdekjes së tij kanë marrë pjesë së bashku me rafidinjtë në tentimin për rrëmbimin e pushtetit nga duart e Ehli Sunnetit. Pushteti nusajrij sirian sot u ndihmojnë grupit sufij “Habeshinj” në Libanon kundër grupit sunnit “Xhemaa Islamije”.

Nuk janë vetëm dervishët që u janë bashkangjitur rafidinjtë kundër Ehli Sunnetit. Gjatë tetimeve për rrëmbimin e kalifatit nga duart e Ehli Sunnetit të gjithë kundërshtarët i bashkonin forcat e tyre. Madje edhe filozofi El-Fasrabi ka marrë pjesë në ekspeditën e rafidinjtë në Damask nën udhëheqjen e Sejfiddevle Hamadanit, sundimtar i shtetit hamdanit shiit në veri të Sirisë.

Për sa i përket armiqëve të vet, Irani i likuidon ata me anë të atentateve, që ka qenë praktikë e rafidinjeve gjatë tërë historisë islame. Nga shembujt më të ri është atentati në alimin pakistan Ihsan Ilahi Zahir, i cili i ka zbuluar me anë të broshurave të veta dhe të cilit ia kanë vërë bombën nën karrige ku është dashur të mbante një ligjëratë.

Para pak kohe Bashkësia Evropiane, me anë të presionit ekonomik, e ka obliguar qeverinë iraniane që të deklarojë se më nuk do t'i përkrah atentatet.

FOTOGRAFI (faqe 64) - *Qeveria iraniane i obligohet Evropës se më nuk do t'i përkrah atentatet!*

Edhe në luftërat kundër Ehli Sunnetit gjatë historisë silleshin dhëlpërisht dhe sulmonin pa shpallje lufte, siç ka qenë rasti i Shah Abbasit në vitin 1603, kur e sulmon Perandorinë Osmane, edhe pse ishte nënshkruar paqja. Parimi i tyre tanimë i përmendur i shtirjes u lejon të mos i përmbahen çfarëdo singëriteti, apo bile sjellje të ndershme në marrëdhëniet me Ehli Sunnetin. Njësoj ndodhi edhe me rastin e tentimit të kryengritjes nga ana e rafidinjeve në Irak gjatë vitit 1991, pas përzërjes së Irakut nga Kuvajti, kur Irani deshi t'i shfrytëzojë trazirat edhe pranë kontratës së nënshkruar me Irakun. Tri ujëdhësa në Gjirin u rrëmbyen nga Emiratit edhe pranë kontratës së nënshkruar. Thjesht, erdhën anijet luftarake dhe e përndjekën papullatën nga aty. Kjo ndodhi në vitin 1994.

Çdo ceremoni të haxhxit rafidinjtë tentojnë të nxisin çrregullime. Në vitin 1989 bombat, të cilat i patën venduar rafidinjtë e Kuvajtit, i patën mbytur shumë haxhilerë të pafajshëm. Vepruesit e kësaj vepre u patën zënë dhe patën

pranuar se eksplozivin ua kishte dhënë ambasada iraniane në Kuvajt.

FOTOGRAFI (faqe 65) - *Brisqit, thikat dhe gurët që i kanë fshehur shiinjtë gjatë demonstratave në haxhillëk dhe i kanë përdorur në përleshjet në sunninjtë. - Në orët, të cilat u janë shpërndarë falas haxhilerëve shkruan "Lebbejke Homeini!" (Të përgjigjem, o Homein!). Haxhilerët myslimanë në haxhshqiptojnë: "Lebbejke All-llahume!" (Të përgjigjem, o All-llahu im!"). - Shiinjtë e Kuvajtit, të cilët i kanë venduar bombat në haxhillëk, pranojnë para kamerave televizive se eksplozivin e kanë marrë nga ambasada iraniane në Kuvajt.*

Iranina vazhdimisht thërret që Meka dhe Medina të vihen nën "udhëheqjen gjithëislame", pasi që nuk janë në gjendje t'i pushtojnë ushtarakisht. Thirrjen e tyre me tërë shpirtin e ndihmojnë sufinjtë dhe sektet e tjera, të cilave u pengon fakti se qeveria e Arabisë Saudite nuk lejon që të bëhen lutjet në varrin e Resulull-llahut s.a.v.s. dhe të Fatimes, vajzës së ndershme të tij.

Fillet e rafidinjtë janë të ndërlidhura me personalitetin e një hebriu nga Jemeni, i quajtur Abdullah b. Seba', i cili pat shkuar te vetë kalifi Uthman që nga dora e tij ta pranojë Islamin, duke shpresuar se ndoshta kalifi do ta shpërblente me nderime të posaçme, e, pasi që nuk ndodhi kështu dhe kur vërejtë se Hixhazi nuk është i përshtatshëm për mbjelljen e rregullirave, shkon në Basër, e pastaj në Siri. Atje e takon as'habin Ebu Dherrin, i cili veçanërisht shquhej me mospërfilljen e dynjallëkut (kësaj bote), e i thotë: "O Ebu Dherr, përese Muaviu e quan mallin e myslimanëve si mall të All-llahut? A mos vallë, dëshiron ta përvetësojë për vete e tua

KUSH JANË SHIJTË?

marrë myslimanëve?” Ebu Dherri e pyet Muaviun për këtë, e ky i përgjigjet: “All-llahu të mëshiroftë, o Ebu Dherr! A nuk jemi ne robër të All-llahut, a nuk është i Tij edhe malli edhe çdo gjë e krijuar, dhe a nuk i përket përcaktimi vetëm Atij?” Ebu Dherri i thotë: “Mos e quaj ashtu!” Muaviu i përgjigjet: “Nuk do të them se nuk është i All-llahut, por do të them ‘malli myslimanësh’. Pastaj Abdullah b. Seba’ shkon te një as’hab tjetër, Ebu Derda, i cili e pyet: “Kush je ti? Pasha All-llahun po më duket se je jehud!” Mandej Ibni Seba bënë përpjekje në Basër dhe në Kufe prej nga që i përzërë, pastaj shkon në Egjipt ku gjenë njerëz të padijshëm, ndër të cilët fillon me ngatërrimet e veta në fshehtësi më të madhe. Kalifi i tretë Uthmani, ishte njeri i butë, që u jipte gjasa shpirtërave të errët ta shfrytëzojnë gatishmërinë e tij për të falur e të vazhdojnë me punët shkatërruese brenda bashkësisë për qëllimet vetiake.

Resulull-llahut s.a.v.s. nuk ka lënë kurrfarë porosie rreth trashëgimitarit të vet, edhe pse në mënyrë të zhdrejtë ka treguar se ky duhet të jetë Ebu Bekri, ngase gjatë kohës së sëmurjes së vet vdekjeprurëse, kërkonte prej tij që ta zëvendësonte në udhëheqjen e namazit. Kur as’habët u këndellën nga trauma e parë pas shpërnguljes së Resulull-llahut s.a.v.s. ne ahiret, u tubua ensarinjtë (medinasit) që nga mesi i tyre ta zgjedhin udhëheqësin e ri të bashkësisë. Mirëpo Muhaxhirët (mekasit) ua përkujtuan hadithin e Resulull-llahut s.a.v.s., sipas të cilit udhëheqja i takon fisit Kurejsh, andaj të gjithë u pajtuan që ky të jetë Ebu Bekri, i cili gjatë kalifatit të vet jestëshkurtër, i shkon për dore t’i rikthej në kraharorin e Islamit fiset që patën reneguar pas vdekjes së Resulull-llahut s.a.v.s.

KUSH JANË SHIJNJTË?

Ebu Bekri, para vdekjes së tij poristë që udhëheqjen ta marrë Umeri. Kalifi i dytë ishte i njohur për rreptësinë e vet, andaj nuk ka pasur përpjekje për çfarëdo kryengritje. Përsianët, të pezmetuar se perandoria e tyre u gjuhëzua gjatë kohës së Umerit, iu hakmarrën atij me atentat, gjersa e udhëhiqte namazin e sabahut. Para vdekjes porositë që kalifi i ri të zgjidhet ndërmjet gjashtë nga dhjetë personalitet e mbetur, të cilëve Resulull-llahu s.a.v.s. u kishte treguar se janë nga banorët e Xhennetit.

Këta gjashtë vet vendosën që nga mesi i tyre kalifi i tretë të jetë Uthmani. Në kohën e tij filluan intrigat e atyre, të cilët e konsideronin se janë të dëmtuar për çfarëdo shkakut qoftë. Kufijtë e shtetit islam u zgjeruan, dhe ekzistonin shpirtëra të sëmurë të cilëve nuk u pëlqente që sundimi të mbetet në duart e kurejshve. Ndërmjet njerëzve të tillë Abdullah ibni Seba' gjenë bashkëpunëtorë të vet. Mirpo, ata mbesin si pakicë e parëndësishme, që kishin për detyrë t'i tërhiqnin penjtë prapa perdes, dhe t'i nxisnin masat naive në kërkimin e të drejtës nga kalifi. Filluan të arrijnë letra të falsifikuara nga Medina, Sria, Basra, Kufa dhe Egjipti me ankesa në mëkëbësit e kalifit. Komplotistë mirren vesh që gjatë kohës së haxhxit të nisen gjithë përnjiherit nga Egjipti e Iraku dhe të takohen para Medinës, e pastaj ta thërrasin kalifin tu përgjigjet ankesave të tyre. Mirëpo, gjatë hyrjes në Medinë, masa e mashtruar ishte e hutuar që as'habët nuk dinin asgjë për letrat e përmendura, të cilat arrinin kryengritësve nga të njëjtët as'habë, në të cilat gjoja se prej tyre kërkonin ndihmë kundër kalifit "i cili e kishte ndryshuar Sunnetin e Resulull-llahut s.a.v.s.".

KUSH JANË SHIJNJTË?

Kalifi del para tyre dhe përgjigjet në të gjitha vërejtjet që i kishin. Pastaj masat kthehen prej nga kishin ardhur - një grup kah Egjipti e tjetri kah Iraku. Këtu Këtu në skenë dalin dy komplotistë, Malik ibni Harith El-Eshter dhe Hukejme ibni Xhebele. Maliki jetonte në Kufë, me prejardhje nga Jemeni. Ishte trim, dhe në betejën e njohur në Jermuk kundër bizantinëve e pat humbur një sy. Mirëpo, mjerisht ishte lakmues i sundimit, që e shtyen të marrë pjesë në fitnen dhe ta shkatërrojë edhe dynjallëkun edhe ahiretin vet. Hukejme jetonte në Basër, me origjinë nga Omani. Ishte i njohur sipas zullumit mbi mercenarët jomyslimanë të shtetit islam, për ç'arsye kalifi Uthman i kishte urdhëruar mëkëmbësit të vet në Basur që mos t'ia lejojnë Hukejmes daljen nga qyteti.

Kur Abdullah ibni Seba' arrin në Basër, vendoset te Hukejme dhe fillon të zgjerjën fitnen e vet ndër të afërmit e tij të pakët, duke thirrur në të drejtën e Aliut, kushëririn dhe dhëndrin e Resulull-llahut s.a.v.s., për shkak të farefisnisë së ngushtë dhe të cilësive mbinatyrore të tij. Mëkëmbësi i Basrës e përzë Ibni Seba'n, e e njëjta gjë i ndodh edhe në Kufë, prej nga shkon në Egjipt ku vazhdon me ndërrimin e poorosive me bashkëmendimtarët e vet. Në varganin e kryengritësve nga Egjipti, të cilët patën ardhur në Medinë, ishte edhe Abdullah Ibni seba'.

Kur kryengritësit e qetësuar u nisën të ktheheshin prapa në krahinat e tyre, Maliku dhe Hukejme e paguajnë një bari që t'ia dërgojë një letër të falsifikuar mëkëmbësit të Egjiptit, përmes së cilës i urdhërohet që t'i ndëshkojë kryengritësit pas kthimit të tyre, duke ia tërhequr vërejtjen bariu të arrijë para kolonës e cila kthehej në Egjipt dhe të sillet i dyshimt kinse dëshiron

KUSH JANË SHIJNJTË?

fshihet prej tyre, në mënyrë që të dyshojnë në të e ta bastisin. Kështu edhe ndodhi, dhe kur e gjetën letrën e falsifikuar, të pezmatuar u kthyen prapa kah Medina. Në të njëjtën kohë Maliku dhe Hukejme dërguan një kalorës tjetër që ta arrijë kolonën e cila kthehej në Basër dhe t'i lajmërojë për letrën dërguar mëkëmbësit të Egjiptit. Kështu që të dy kolonat kthehen prapa në medinë dhe shkojnë tek Aliu, pasi që letra e falsifikuar ishte e nënshkruar nga ai. Ndërkaq ai refuzon se kishte dërguar ndonjë letër dhe u thotë: “Si e kuptuat ju nga Basra dhe Kufa për atë që u ka ndodhur egjiptasve, pasi që u ndatë gjithkush në anën e vet? Kjo, pasha All-llahu, është kurdisur në Medinë!” Duke mos ditur se si të përgjigjeshin, i thanë që këtë ta komentojë si të dojë vet.

Letra e dytë ishte e nënshkruar me emrin e Aishes, bashkëshortës së Resulull-llahut s.a.v.s. Ajo kthehet në Medinë pas kryerjes së Haxhxhit, dhe duke e hasur të vrarë kalifin Uthman, i sulmon as’habët që e kishin lejuar këtë. Në këtë kryengritësit i thanë se ajo vetë i kishte ftuar me letër, në çka Aisha betohet se askujt nuk i kishte dërguar ndonjë letër.

Duke parë se Aliu nuk dëshiron t’u shoqërohet, kryengritësit nisen për në shtëpi të kalifit. Ky u del përpara dhe refuzon se din gjë për ndonjë letër dërguar në Egjipt, dhe kërkon prej tyre dy dëshmitarë për atë që konfirmojnë. Ndërkaq këta kërkojnë prej tij që ta braktisë kalifatin, ose do të jetë i mbytur. Në koleksionin e haditheve të Ibni Maxhes (I/kaptina XI) dhe Ahmedit (VI/ f. 75) transmeton bashkëshortja e Resulull-llahut s.a.v.s. Aisha se i Dërguari i All-llahut i ka thanë Uthmanit: **(TEKSTI ARABISHT)** “O uthgman! Nëse ndonjëherë të ngarkon All-llahu me kalifat, e

KUSH JANË SHIJNJTË?

munafikët kërkojnë prej teje ta zhveshësh këmishën me të cilën të ka veshur All-llahu (d.m.th. kalifatin), mos e zhvish atë!”

Dhe, me të vërtetë, nuk deshi Uthmani ta braktisë kalifatin në presion, që të mos bëhet ky shembull për të ardhmen, por njëkohësisht ua ndalojë as’habëve të fillojnë luftën me bunxhinjtë, që të mos derdhet gjaku i myslimanëve për shkak të tij, ndërsa Ibni Abbasit i urdhëroj që t’i dërgojë njerëzit në haxh. Bunxhinjtë ia rrethojnë shtëpinë dhe rrethimi zgjati tri javë. Muaviu, kushëriri i tij, i ofron t’ia dërgojë një çetë nga Siria për ta nxjerrë nga rrethimi, mirëpo kalifi edhe këtë e refuzon, duke mos dashur t’u shkaktojë telashe medinasve për vendosjen e ushtrisë. Ali i dërgoi dy djemtë e vet, Hasanin dhe Huseinin t’i ruajnë dyert. Talha e dërgoi djalin e vet Muhammedin, kurse Zubejri djalin e vet Abdullahun dhe shumë as’habë i dërguan djemtë e tyre. U tubuan edhe Ebu Hurejre dhe Abdullah ibni Umeri, dhe rreth shtatëqind njerëz morën pjesë në mbrojtjen e kalifit, e dajali i Aliut, Hasani që i plagosur, mirëpo, më në fund kalifi u urdhëroi të gjithëve të kthehen në shtëpitë e tyre, me çrast kryengritësit hyjnë brenda dhe e vrasin.

Në përmbledhjen e vet të haditheve (IV/7/62) Buhariu transmeton Nga Ebu Musa El-Eshariu r.a., i cili mori abdest në shtëpinë e vet, pastaj doli nga shtëpia dhe tha: “Gjithsesi do ta shoqëroj Pejgamberin s.a.v.s. dhe do ta kaloj me të këtë ditë”. Shkoi në xhami dhe pyeti për Pejgamberin s.a.v.s. Të pranishmit i thanë: “Shkoi atje!” Esh’ariu tha: “Unë dola prej xhamisë dhe shkova pas tij, duke pyetur për të, derisa arrita te pusi i Erisit. Aty qëndrova te dera, derisa Pejgamberi s.a.v.s. i kreu punët e veta dhe mori abdest. Pastaj u ngrita afër tij,

KUSH JANË SHIJNJTË?

ndërsa ai ishte ulur në pusin e Erisit, qëndronte në mesin e lartësisë së pusit, i kishte përvjelur këmbët dhe i kishte lëshuar në pus. Unë e përshëndeta me selam, pastaj u ktheva dhe u ula te dera dhe thashë: “Vërtet sot do të jem portieri të Pejgamberit s.a.v.s”. Pastaj arriti Ebu Bekri r.a. e shtyu derën dhe unë i thashë: “Kush është?” Tha: “Unë jam Ebu Bekri”. Unë pastaj ia ktheva: “Prit pak!” Pastaj shkova te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i thashë: “Ebu Bekri kërkon leje të hyjë!” Pejgamberi s.a.v.s. tha: *“Lëre të hyjë dhe përgëzoje se do të shkojë në Xhennet!”* Unë pastaj u ktheva te Ebu Bekri dhe i thashë: “Urdhëro, hyr. Pejgamberi s.a.v.s. të përgëzon me Xhennet. Ebu Bekri hyri dhe u ul në anën e djathtë të Pejgamberit s.a.v.s. në pjesën e sipërme të arkës së pusit dhe të dy këmbët i shtiu në pus, ashtu siç kishte vepruar i Dërguari i All-llahut, dhe i përvoli teshat. Unë prapë u ktheva dhe u ula, dhe e lashë në shtëpi vëllain tim të marrë abdest dhe të vijë pas meje.

Atëherë kam thënë: “Nëse All-llahu xh. sh. i jep ndonjë të mirë (duke menduar në vëllain tim, i cili kishte mbetur në shtëpi duke marrë abdest), do t’i vijë”.

Kur, dikush trokiti në derë, dhe unë pyeta: “Kush është?” Ai u përgjigj: “Umeri, i biri i Hattabit!” Unë i thashë: “Prit pak!” Pastaj shkova te Pejgamberi s.a.v.s. , e përshëndeta me selam, pastaj i thashë: “Umeri kërkon të hyjë!” Pejgamberi s.a.v.s. tha: *“Lëre dhe përgëzoje me Xhennet”*. Unë u ktheva te Umeri r.a. dhe i thashë: “Urdhëro, hyr! Pejgamberi s.a.v.s. të përgëzon me Xhennet”. Ai hyri dhe u ul në anën e majtë të Pejgamberit s.a.v.s. në pjesën e epërme të pusit dhe i shtiu këmbët në të.

Pastaj unë u ktheva, u ula dhe thashë: “Nëse All-llahu ia dëshiron të mirën (mendon në vëllain e vet), do t’i vijë”.

Atëherë dikush trokiti në derë. Unë prapë pyeta: “Kush është?” Ai u përgjigj: “Uthmani, i biri i Affanit”. Unë iu përgjigja: “Prit pak!” Pastaj shkova te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e lajmërova për ardhjen e Uthmanit. Pejgamberi s.a.v.s. tha: *“Lëre të hyjë dhe përgëzoje me Xhennet si dhe belanë e cila do t’i ndodhë”*. Unë u ktheva te Uthmani dhe i thashë: “Urdhëro, Pejgamberi s.a.v.s. të përgëzon me Xhennet dhe belanë e cila do të ndodhë”. Uthmani r.a. e gjeti pjesën e epërme të pusit të mbuluar dhe u ul në anën tjetër të pusit”.

Seid ibni Musejjeb thotë: “Uljen e këtyre e kam shpjeguar me varrezat e tyre”.

Në koleksionin e haditheve të Ahmedit (I/407), Tirmidhiut (IV/324), Ibni Mazhes (I/41) dhe Hakimit (III/99) transmeton ndihmësi i Uthmanit, Ebu Sehle se i ka thënë Uthmani gjersa ishte i rrethuar: **(TEKSTI ARAB)** “Ma ka dhënë Resulull-llahu s.a.v.s. një premtim për shkak të të cilit do të durojë.”

Në koleksionin e Ahmedit (I/526) transmetohet se si Uthmani i ka lirua njëzrt robër dhe ka kërkuar shallvaret çfarë kurrë më parë nuk i kishte veshur, as në xhahilijet as në Islam, duke thënë: “Sonte e kam parë në ëndërr Resulull-llahun s.a.v.s., e me të Ebu Bekrin dhe Umerin, të cilët më thanë: “Ki durim, natën e ardhshme je te ne në iftar.” Pastaj e kërkoj Musafin, e hapi ndërmjet duarve, dhe e mbytën me Kur’an ndërmjet duarve, ndërsa pikat e gjakut ranë në ajetin kur’anor: *“kundër tyre do të mjaftojë All-llahu, e Ai i dëgjon të gjitha dhe i din të gjitha.”* (El-Bekare: 137).

Kryengritësit egjiptas e pritën Aliun i cili kishte qenë në truallin e vet jashtë Medinës, që t'i betohen si kalifit të ri, por ky refuzoi derisa nuk tubohen as'habët nga Bedri dhe i mallkoi vrasësit e kalifit. Kryengritësit nga Kufa kërkun të njëjtën gjë nga Zubejri, por edhe ky refuzoi. Kryengritësit nga Basra kërkuan këtë nga Talha, por edhe ky refuzoi. Njësoj vepruan edhe Ibni Ebi Vekkasi dhe Abdullah Ibni Uneri. Pas pesë ditësh anarkie, e rrokën Alun në shesh dhe kërkuan prej tij që ta ndërpret çrregullimin dhe të pranojë kalifatin, dhe së pari erdhën t'i betohen Talha, Zubejri dhe Sa'd Ibni Vekkasi.

Vrasja e kalifit Uthman ishte fillimi i përçarjes brenda ummetit mysliman. Që nga atëherë e më tej, do të jemi dëshmitarë të paraqitjes së asaj për çka flet kjo broshurë - sektet e çoroditura të cilat ndërruan mësimin burimor të Islamit. As'habi Semura ka thënë: **(TEKSTI ARAB)** "Islami që në kjeshtjellën e fortifikuar, por ia hapën plasaritjet me vrasjen e Uthmanit, të cilat nuk do të mbyllen dot gjer në Ditën e Kiametit; dhe vërtetë, kalifati që ndër banoret e Medinës por e përzënë atë dhe nuk do t'u kthehet kurrë më."

Kur lajmi për vrasjen e kalifit arriti në Damask, dhe këmisha e përgjakur e kalifit që e shtrirë në mimber, Muaviu mbajti një fjalim të përmortshëm dhe refuzoi t'i zotohet kalifit të ri përderisa nuk ia dorëzojnë vrasësit e kalifit Osman të cilin e kishte kushëri, ndërsa afro gjashtëdhjetë mijë njerëz u betuan në kërkimin e hakmarrjes së kalifit. Disa nga as'habët e braktisën Medinën dhe shkuan në Siri. Aliu vendosi të niset për në Siri, mirëpo banorët e Medinës nuk pranuan t'i shoqërohen. Djali i tij Hasani gjithashtu ishte kundër ekspeditës në Siri.

KUSH JANË SHIJNTË?

Aisha tanimë ishte kthyer në Mekë, e të njëjtën gjë kërkuan edhe Talha, Zubejri dhe Abdullah Ibni Umeri.

Aisha, Talha dhe Zubejri në Mekë vendosën të ndërmjetësojnë ndërmjet dy palëve, ndërsa Abdullah Ibni Umeri nuk dëshiroi t'u shoqërohet. Vendosiën që së pari të shkojnë te Muaviu në Damask, por Abdullah Ibni Amiri, i cili ishte mëkëmbës i Uthmanit në Basër, dhe i cili kishte ikur në Mekë pas lajmit të vrasjes së kalifit, i bindi që të mos e bëjnë një gjë të tillë por të shkojnë në Basër dhe të kërkojnë dëmshpërblimin për vrasje nga fisi i vrasësve të kalifit, duke mos kërkuar për këtë leje nga kalifi i ri Aliu, i cili mbeti i rrethuar nga kryengritësit në Medinë, i braktisur nga shumica e as'habëve, për ç'arsye kryengritësit bëheshin gjithnjë e më autoritativ. Kur dëgjoi për ekspeditën nga Meka për në Basër, Aliu iu frikësua kryengritjes dhe u nis t'ua ndërprente rrugën, por këta qenë më të shpejtë. Prandaj e dërgoi Amar Ibni Jasirin dhe djalën e vet Hasanin që t'i ngritë në këmbë njerëzit e Medinës dhe Kufës, ndërsa ai vet vazhdoi rrugën për në Basër. Ndërkaq në Kufë as'habi Ebu Musa El-Esh'ari dhe një pjesë e kufasëve refuzuan ta përkrahin ciliundo qoftë dhe më me andje u përcaktuan për neutralitet. Mëkëmbësi i Aliut në Basër Uthman Ibni Hunejfe doli para Aishes, Tahlas, dhe Zubeirit, të cilët i treguan për çka kishin ardhur dhe u morën vesh që ta presin ardhjen e Aliut në Basër.

Ibni Haxheri transmeton në "Fethul Bari" (13/41) nga libri i Umer Ibni Shebbes "Lajmet nga Basra" fjalët e Muhallebit: "Askush nuk ka transmetuar se Aisha apo kushdo qoftë tjetër, që ka qenë me të, kanë dëshiruar ta marin kalifatin nga Aliu, e

as që i kanë thirrë njerëzit që ndokend prej tyre ta shpallin për kalif.”

Gjatë pritjes së Aliut, ata që kishin marrë pjesë në kryengritjen kundër Uthmanit në krye me Hukejmen, të cilin tanimë e kemi përmendur si prijës të ngatërrestarëve rreth Abdullah Ibni Seba’it, tentuan të shkaktojnë trazira, duke u frikësuar se Aisha dhe Aliu do të mund të mirren vesh në dëm të tyre, kurse mëkëmbësit Uthmanit ia penguan ardhjen. Hukejme filloi të flasë kundër Aishes, në çka një grua nga fisi i tij iu përgjigj: “I biri i gruas së poshtër, këtë çka thua për Aishen më parë të përgjigjet ty!”, pas çkafit ky e mbyti, ndërsa shumica nga fisi i tij ia kthyen shpinën. Gjatë trazirave plagoset dhe zihet. Pastaj Talha dhe Zubejri i thirrën fiset e Basrës t’i dorëzojnë ata që kishin marrë pjesë në fushatën e Medinës, dhe të gjithëve ua prenë kryet sikurse edhe Hukejmes, të cilit koka i mbeti varur në shpinë. Pas ardhjes së Aliut, me ndërmjetësimin e as’habit Ka’ka’ Ibni Amir Temimiut, dy palët u morën vesh ta zgjidhin problemin në mënyrë paqësore, e u përzier në mes veti shokët e vjetër dhe nata kaloi në qetësi.

Mirëpo, komplotistët nuk flinin, pasi që ishin të vetëdijshëm se, nëse konflikti zgjidhet paqësisht, kjo mund të jetë vetëm në llogari të tyre. Prandaj tërë natën diskutuan se çka duhet bërë dhe më në fund vendosën ta fillojnë luftët nga të dy anët, që secili të mendojë se është i mashtruar. Dhe, me të vërtetë, rrjedha e ngjarjes u doli nga duart prijësve dhe lufta përfundoi me mijëra të vrarë, ndër të cilët ishin edhe Tahla dhe Zubejri. Për sa i përket shefave të komplotistëve, si përfundoj Hukejme e përmendëm, ndërsa Malik El-Eshteri u përlesh në luftë me Abdullahun, djalin e Zubejrit, të cilën ndërruan mjaftë

KUSH JANË SHIJNTË?

të rëna, e Abdullahu briti: “Më mbytni mua dhe Malikun!”, duke e ditur se çfarë reziku paraqet ky ngatërrestar për bashkësinë, por njerëzit nuk e njihnin Malikun sipas emrit - e njihnin vetëm si “Eshter”, andaj këtij i shkon për dore që të ikën.

Pas kësaj beteje, e cila është e njohur me emrin “Devja”, ngase Aisha ishte e fshehur nga njerëzit në shkalc mbi deve, Aliu e la Abdullah Ibni Abbasin mëkëmbës në Basër, për çka Maliku u hidhërua e tha: “Përse atëherë e mbytëm plakun (duke menduar në Uthmanin), Basra Abdullahut e Kufa Aliut!” Më vonë lufton me Aliun kundër Muaviut, e Aliu e emëron mëkëmbës të Egjiptit. Kur arrin në Kalzum (Suezin e sotëm) e pin një gotë pije me mjaltë dhe bie i vdekur, andaj mendojnë se ndoshta ka qenë i helmuar. Gjatë luftimit Aisha kërkoi nga Ka’b Ibni Suver El-Ezdriu, të cilin kalifi i dytë Umeri e pat vendosur për kadi në Basër, ta ngritë Kur’anin dhe ti thërret njerëzit në të, por komplotistët e goditën me shigjetë. E, edhe Aishën e gjuajtën me shigjetë. Pastaj Ajo bërtiti: “O njerëz, mallkoni vrasësit e Uthmanit dhe partinë e tyre!” dhe filloi edhe vetë t’i bënë dua All-llahut që t’i mallkojë ata. Kur Aliu dëgjoi zhurmën, pyeti për çka ishte fjala, dhe kur i treguan filloi edhe vet të lutet për mallkimin e vrasësve të Uthmanit dhe partinë e tyre, dhe të dy palët filluan sinqerisht të bëjnë dua, në luftë që ua kurdisën munafikët.

Në historinë e Ibni Asakirit (7/86) rrëfen Sha’bi se kur pas lufte Aliu e kishte parë Tahlan të gjuajtur në një luginë, ia kishte fshirë dheun nga fytyra duke thenë: “Është tejet e rëndë për mua, o baba i Muhammedit, të të shoh të hedhur në luginë në yjet e qiellit. I ankohem All-llahut për pikëllimin tim! Sikur

të jipte Zoti që të vdisja para njëzet vitesh!”Ebu Habibi, ndihmësi i Talhas thotë: “Unë dhe djali i Tahlas Imrani hymë tek Aliu pas betejës, e Aliu e priti me mirëseardhje dhe e uli pranë vetes e tha: “Shpresoj se All-llahu do të më bëj mua dhe babain tënd prej atyre për të cilët tha: ***“Dhe nga zemrat e tyre shkulëm çdo gjë që kishte nga urrejtja, vëllezër në divane njëri përballë tjetrit.”*** (El-A’raf: 43).Ishte i pranishëm edhe Haris El-E’vari, i cili më vonë do të bëhet njëri nga prijësit rafidij, i cili tha: “All-llahu është më i drejtë nga ajo që njëherë t’i mbysim, e pastaj të na bëhen vëllezër në Xhennet!” Aliu ia ktheu: “Shko në vendin më të largët dhe më të skajshëm të Tokës, nëse nuk jemi unë dhe Talha në Xhennet atëherë kush është?”, dhe e hodhi shishe mereqepin në Harisin, porse nuk e goditi. Atëherë ndërhyri Ibnul Keva, njëri nga prijësit e kryengritjes kundër Uthmanit, e më vonë prijës i havarixhinjve që u ngritën kundër Aliut, e tha: “All-llahu është më i drejtë nga kjo!” Aliu e goditi me kamxhik duke thënë: “Ti, që nuk e njeh as nënën tënde, dhe shoqëria jote e mohoni këtë?”

Në “Ferk bejnel-firek” të Bagdadiut (f. 58), autori konsideron se një nga shkaqet e paraqitjes së havarixhinjve, për të cilët kemi folur më herët, është fakti se Aliu nuk ka lejuar që me taborin kundërshtar të veprohet si me jobesimtarë. Havarixhinjtë, me proklamimin tejet të lehtë të myslimanëve si jobesimtarë, do ta kënaqin epshin e vet për gjakun dhe nderin e myslimanëve. Në “Ensabul eshraf” të Belazuriut gjejmë se si një herë Aliu i kishte hasur vajzat e veta duke qarë dhe i kishte pyetur “Ç’keni e po qani?” Ato thanë: “Qajmë për Uthmanin.” Në çka edhe Aliu filkloi të qajë e tha: “Qani...”

KUSH JANË SHIJNTË?

Pas betejës Aliu vajti tek Aishja e i tha: “Të faltë All-llahu!” Ajo u përgjigj: “Edhe ty, unë nuk deshta asgjë tjetër pos pajtimit.” Pastaj e gostit në Basër dhe e pajisi për rrugë së bashku me vëllain e saj Muhammedin për në Medinë dhe e përcolli atë së bashku me djemtë e vet.

Aliu qëndroi në Basër pesëmbëdhjetë netë, e pastaj u nis për në Kufë, të cilën e zëvendësoi për kryeqendër të kalifatit me Medinën, edhe pse djali i tij Hasani i propozonte kryeqendrën e vjetër.

Më vonë do të shohim se si rafidinjtë sharjen e as’habëve - shokëve të Resulull-llahut s.a.v.s. , do ta bëjnë themel të fesë së vet. Këtë rast do ta shfrytëzojnë që ta sulmojnë Talhan dhe Zubeirin si besëthyes, të cilët ia patën dhënë besën Aliut, e pastaj u ngritën kundër tij. Gjatë kësaj, natyrisht, ata nuk do të përmendin se këta nuk kanë dashur ta rrëmbejnë pushtetin, porse kanë dashur pajtimin mes myslimanëve duke i zënë vrasësit e kalifit Uthman. Njësoj kanë vepruar edhe me nënën e besimdrejtëve, bashkëshorten e Resulull-llahut s.a.v.s., Aishen, për të cilën Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: **(TEKSTI ARAB)** *“Krijesa më e dashur për mua është Aisha, ndërsa burrave babai i saj.”*, të cilën e akuzojnë se ka marrë pjesë në kryengritje kundër kalifit Uthman (duke mos përmendur refuzimin e saj). Kanë trilluar edhe “hadithin” sipas të cilit Resulull-llahu s.a.v.s. i thotë bashkëshortes së vet: “Do të luftosh kundër Aliut dhe do të bie përgjegjësia.”

Rafidinjtë përndryshe janë të njohur për trillimin e “haditheve” të cilat ia vënë Resulull-llahut s.a.v.s. në gojë, apo ndonjërit nga imamët e tyre të cilt i konsiderojnë të pagabuar, prandaj edhe të folmet e tyre është gjithashtu shpallje (!!)

Shkenca islame e Hadithit ua ka shkelur bishtin gënjeshtreve të tyre, me atë se nuk pranon kurrnjë hadith të Resulull-llahut s.a.v.s. pa zingjirin e transmetuesve, i cili shpien nga autori i koleksionit të haditheve gjer te vetë Resulull-llahut s.a.v.s.

Për t'u dalluar transmetuesit besnik nga ata gënjeshtarë, janë përpiluar libra të cilat gjerësisht flasin për çdo emër që ka hyrë në zingjirin e transmetuesve të hadithit. Në këtë mënyrë lehtë mund ta zbulojmë rrenacakun në zingjirin e transmetuesit, dhe gjithashtu se a ka dëgjuar hadithin çdonjëri në zingjirin e transmetuesve nga ai para tij apo jo, ngase në librat mbi transmetuesit e hadithit përmendin çdo transmetues se prej kujt e ka dëgjuar hadithin dhe kush e ka dëgjuar prej tij. Kjo fe e lartësuar ka mbetur e ruajtur nga ndërrimet duke i falënderuar prezencën e dijetarëve në çdo brez myslimanë. Resulull-llahut s.a.v.s. ka thënë: **(TEKSTI ARAB)** *“Këtë fe e bartin nga çdo brez njerëzit e drejtë, duke e mbrojtur nga shtrembërimet e atyre që e teprojnë, nga shpifjet e rrenacakëve dhe nga komentimet e gabuara të injorantëve.”*

Për t'ia afruar lexuesit këtë shkencë, e cila nuk ekziston te asnjë fe tjetër, përveç në të tonën, dhe falë qoftë së cilës e kemi ruajtur Hadithin e Resulull-llahut s.a.v.s. nga gënjeshttrat, do të jap një shembull të një hadithi të trilluar nga ana e rafidinjeve, lidhur me betejën për të cilën bëm fjalë. Rafidinjtë rrëfejnë se një herë Resulull-llahu s.a.v.s. e kishte pyetur bashkëshortet e veta se në cilën prej tyre do të lehin qentë kur të kalojnë afër burimit të quajtur Hev'ab (afër Basrës). Dhe me të vërtetë, thonë ata, kur Aishja kaloi atypari me Talhan dhe Zubejrin duke vajtur në Basër, qentë lehën, andaj deshti të kthehej kur dëgjoj se mu ashtu quhej ai vend, por Talha dhe Zubejri u

KUSH JANË SHIINJTË?

betuan rrejshëm se ky nuk ishte Hev'abi, për ta bindur që ta vazhdojë rrugën. Kështu rafidinjtë dëshirojnë t'i paraqesin Tahlan dhe Zubejrin si gënjeshtarë.

Taberiu e ka shënuar këtë përrallë të tyre, por e ka shënuar edhe zingjirin e transmetuesëve, prej të cilit kuptojmë se përrallën e ka treguar Ismail Ibni Musa El-Fezari të cilën e ka dëgjuar nga një beduin i panjohur prej të cilit Aisha e kishte blerë një deve dhe i cili e kishte vazhduar rrugën me karvanin e tyre dhe kishte qenë dëshmitar i ngjarjes së përmendur. Shkenca e Hadithit, natyrisht, nuk pranon zingjirin e transmetuesve në të cilin dikush është i panjohur, sikurse ky beduin, e nëse i kthehemi librit të transmetuesve, do të gjejmë se Inbi Adijj thotë për këtë Ismailin se ka qenë rafidij i pasionuar. Përdryshe specialitet i rafidinjeve është sharja e shokëve të Resulull-llahut s.a.v.s., e veçanërisht tre kalifët e parë, të cilët i akuzojnë se ia kanë rëmbyer kalifatin Aliut, ndërsa shokët e tjerë i akuzojnë për tradhti, pasi që nuk janë ngritur kundër këtyre treve.

Për ta dëshmuar këtë gjoja të drejtë të Aliut në kalifat, si dhëndër i Resulull-llahut s.a.v.s. (e assesi nuk përmendin se Uthmani ka qenë dhëndri i dyfishtë i Resulull-llahut s.a.v.s., burrin e Rukajjes e pas vdekjes së saj, burrin e Ummu Kulsumes), rafidinjtë kanë trilluar “argumente” të reja, me të cilat nuk kanë mundur të kalojnë te njerëzit e dijshtëm dhe te ata që i përcjellin njerëzit e dijshtëm, por kanë mundur t'i mashtrojnë injoratët dhe besëtytët. Është e qartë se ata nuk merakoseshin për Aliun as për familjen e tij dhe nipërit e tij, por kishin për qëllim të bëjnë trazira dhe ta dobësojnë bashkësinë islame nga brenda. Qysh para se të fillonte të

thërriste në mbinatyrshtëmërinë e Aliut dhe në të drejtën e trashëgimit të Resulull-llahut s.a.v.s. për udhëheqjen e shtetit islam, Abdullah Ibni Seba' ka bërë eksperimente ndër masat egjiptase se çka do të mundej të nxiste çrregullime, andaj së pari filloi me çështjen e kthimit të sërishëm të Resulull-llahut s.a.v.s. në dunjallëk, duke thënë se si çuditet që myslimanët besojnë në kthimin e sërishëm të Isait a.s., e për Muhammedin nuk thonë se përsëri do të paraqitet **në dunjallëk**. E, vallë, a nuk është Muhammedi më meritori ndër Pejgamberët e tjerë.

Natyrisht, njeriu i padijshëm mund të lëkundet në qëndrim, veçanërisht nëse nuk ka kontakt me dijetarët e fesë. Resulull-llahu s.a.v.s. në të vërtetë na ka informuar për riardhjen e të Dërguarit të All-llahut Isain a.s., si një nga parashenjat e Ditës së gjykimit, siç naka informuar edhe i Lartësuarit se armiqët nuk e kanë mbytur Isain, e as që e kanë gozhuar në kryq, porse vetëm iu është dukur, dhe se All-llahu e ka ngritur pranë Vetes. Isai kthehet në Tokë për ta mbytur Dexhxhallin, i cili shpallet si hyjni dhe të cilin e pasojnë shumë njerëz. Ushtria myslimane, në krye me Mehdiun e mund ushtrinë e Dexhxhallit, kurse Isai e then kryqin dhe e mbytet derrin (simbolet e të krishterëve). Është me rëndësi të përmendet se Isai nuk vjen si pejgamber i ri, porse ai ka detyrë të caktuar, e paastaj vdes sikurse çdo njeri i vdekshëm. Kur she Abdullah Ibni Seba' se intrigat e tij hasin në mirëkuptim, fillon të rekomandojë mbinatyrshtëmërinë e Aliut, në mënyrë që ta ngulitë premisën mbi paracaktimin e Aliut si trashëgimtar të Resulull-llahut s.a.v.s., e drejta e të cilit është rrëmbyer me dhunë. Nga "argumentet" që ua parashitrojnë rafidinjtë masave të padijshme për këtë paracaktim të Aliut, janë shumë

“hadithe” të trilluara, por, nëse kanë punë me ndonjë sunni të arsimuar, duke e ditur se ky nuk do t’i pranojë gënjeshtat e tyre, e as komentimin e ajeteve kur’anore ashtu si u pëlqen atyre, nuk u mbetet asgjë tjetër pos t’i përvishen dinakërive.

Me një rast Resulull-llahu s.a.v.s. i pat thënë Aliut: **(TEKSTI ARAB)** *“A nuk je i kënaqur që të jesh ndaj meje si Harunu ndaj Musit, përveç që më nuk ka pejgamber pas meje?”*

Rafidinjtë thonë se sikur të mos kishte vdekur Haruni para Musait, do të ishte trashëgues i tij, që do të thotë se në ujdin me këtë hadith Aliu duhet të jetë trashëgues i Muhammedit. Dhe jo vetëm trashëgues në udhëheqjen e bashkësisë, por edhe trashëgues në komentimin e Shpalljes! Dhe jo vetëm Aliu, por edhe djemtë e tij, nipërit, stërnipërit... Vetëm se nuk kanë përmendur se kur i ka thënë Resulull-llahu s.a.v.s. këto fjalë. Kishte të bëjë në realitet me fushatën në Tebuk kundër Bizantit, e Resulull-llahu s.a.v.s. sa herë që shkonte në ndonjë fushatë, e linte njërin nga ashabët në Medinë me joluftarët që të udhëheqë me qytetin. Kësaj radhe e caktoi Aliu, e këtij i erdhi vështirë që të mos shkonte në këtë betejë kaq të rëndësishme (gjë tek përleshja as që ka ardhur, ngase bizantinët nuk guxuan të vinin), andaj tha: **(TEKSTI ARAB)** *“A më lë t’i udhëheqi femijët dhe gratë?”* Për ta disponuar Resulull-llahu s.a.v.s. i tha: *“A nuk je i kënaqur që të jesh ndaj meje si Harunu ndaj Musit, përveç që më nuk ka pejgamber pas meje?”* Përkatësisht, kur Musai a.s. pat shkuar të marrë Tevratin nga All-llahu në kodrën e Sinajit, e pat lënë Harunin, i cili gjithashtu ishte Pejgamber, që të udhëheq me popullin hebre. Kështë edhe unë të lë ty o Ali, vetëm që ti nuk je

KUSH JANË SHIJNTË?

Pejgamber siç ka qenë Haruni, ngase unë jamë i fundi nga radha e të Dërguarve të All-llahut. E, rafidinjtë harrojnë se Resulull-llahu s.a.v.s. edhe para Aliut ka lënë as'habë të tjerë që të udhëheqin me Medinën gjatë fushatave të tjera, përse atëherë edhe atyre nuk ua kanë përshkruar të drejtën të jenë trashëgimtarë të Resulull-llahut s.a.v.s., në udhëheqje me bashkësinë dhe në komentimin e Shpalljes?

Me një rast tjetër Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë për Aliun: **(TEKSTI ARAB)** *“Kujt i jam unë mik, edhe Aliu i është mik”*. Edhe këtu rafidinjtë tentojnë të gjejnë argument për pretendimin e tyre, ngase fjala “mevla” përpos që do të thotë “mik” mund të ketë kuptimin edhe “sundues”. Porse vetë nipi i Aliut, Hasani djali i Hasanit, u është përgjigjur kur e kishin pyetur për këtë hadith: “Pasha All-llahun, Resulull-llahut s.a.v.s. me këtë nuk ka pasur për qëllim udhëheqjen e bashkësisë. Sikur të donte kështu atëherë do të thoshte qartë: “O njerëz, ky është njeriu që do t’ju udhëheqë pas meje, andaj dëgjoje dhe bindjuni atij.” Pasha All-llahun, si të caktonte All-llahu dhe i Dërguari i Tij që Aliu të jetë udhëheqës i myslimanëve, pas tij, e vetë Aliu nuk iu ka përmbajtur këtij përcaktimi,, atëherë vetë Aliu do të ishte i pari që nuk e ka përfillur urdhërin e All-llahut dhe urdhërin e Resulull-llahut s.a.v.s.

Dhe, me të vërtetë, kur rafidinjtë i akuzojnë shokët e Resulull-llahut s.a.v.s. për rrëmbimin e të drejtës të Aliut për udhëheqjen e bashkësisë e cila i është caktuar nga All-llahu, siç falsifikojnë ata, ata në realitet e akuzojnë edhe vetë Aliun i cili në këtë rast e ka lënë në heshtje këtë të drejtë të vet dhe kështu s’ja ka vënë veshin përcaktimit të All-llahut. Dhe jo vetëm kaq,

porse kjo paraqet edhe akuzimin e vetë Resulull-llahut s.a.v.s., për fshehjen e asaj që është dashur t'ua shpallë njerëzve.

Homeini në librin e vet “Keshful esrar” thotë: “Duket qartë se, sikur i Dërguari të përpiquej pak më tepër për kumtimin e urdhërit të Zotit përkitazi me vendosjen e imametit pas vdekjes së tij, nuk do të vinte gjer tek të gjitha këto dallime në bazat e fesë dhe në kufijtë e saj.” Pastaj Homeini konfirmon se Resulull-llahu s.a.v.s. ka qenë i frikësuar nga reaksioni i as’habëve, andaj e ka fshehur urdhërin e Zotit që Aliu ta trashëgojë Resulull-llahun s.a.v.s.: “Dhe do të sjellim argument nga Kur’ani se si i Dërguari ka qenë i kujdesshëm nga përmendja e imametit, duke u frikësuar nga munafikët (d.m.th. nga as’habët): ***“O Pejgamber! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! - Në qofrë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke kumtuar porosinë e Tij, e All-llahu të ruan ty prej njerëzve. Se, All-llahu, me të vërtetë, nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin jobesimtar.”*** (El-Maide: 67).

Në këtë mënyrë Homeini e ka shndërruar thirrjen e Resulull-llahut s.a.v.s. në Islam drejtuar mushrikëve, në thirrje në imametin e Aliut, të djemve të tij dhe të nipërve të tij, ndërsa as’habët i ka bërë popull jobishtar!!

Homeini thotë: “Të emëruarit e trashëgimtarit ka qenë plotësim i misionit të Pejgamberit.” “...E sikur të mos e caktonte trashëgimtarin, nuk do t’i përmbushte detyrat e veta.”

Pastaj Homeini sjell argument nga libri shiit “Sherh Nehxhil-Belaga”, nga Ibni Ebi Hadidi dhe “Tarihu Bagdad”, nga Ebi Tahiri, ku Umeri (kalifi) i dytë “pranon”: “Në shtratin e vdekjes Pejgamberi ka dashur t’ia bënë testament Aliut imametin, por e kam penguar në këtë!, në çka thotë Homeini:

KUSH JANË SHIJNJTË?

“Librat historike na tregojnë se ky kufër është vepër e Umerit, dhe se as’habët e kanë përkrahur dhe nuk e kanë lënë Pejgamberin të shkruajë çka ka dashur.”

Në një vend tjetër Homeini thotë: “Argumenti kryesor tradicional shiit, se tre kalifët e parë kanë qenë uzurpatorë është se ata shpeshherë nuk e kanë njohur Ligjin dhe procedurën e tij.”

Megjithatë, problem i përhershëm për rafidinjtë mbetet pyetja: përse trashëgimia e Aliut në krye të shtetit dhe të komentuesit të Shpalljes nga Resulull-llahu s.a.v.s., e cila pas tij bartet në dymbëdhjetë pasardhës të tij, nuk është përmendur në Kur’an, e në këtë mënyrë problemi të jetë i zgjidhur? Për këta ata kanë gjetur disa përgjigje. Ose do ta komentojnë ndonjë ajet kur’anor me domethënie “të fshehtë, ashtu si u pëlqen atyre, për shembull në kaptinën Tevbe, ajetin 36 i Lartmadhërishmi thotë: ***“Numri i muajve të All-llahut është dymbëdhjetë, sipas Librit të All-llahut...”***

“Alimi” rafidij Bahrani në librin “Gajetul Meram” transmeton një “hadith” të cilin ia vëjnë Resulull-llahut s.a.v.s. në gojë: “O njerëz, kush dëshiron të më pasoj mua, le t’i nënshtrohet vilajetit të Aliut dhe iamëve pasardhësve të mij, sepse ata janë thesar i diturisë sime!” E, Xhabir Ibni Abdullah El-Ensari u ngrit e pyeti: “O i Dërguari i All-llahut, sa është numri i tyre?” I Dërgualli i All-llahut ia citoi ajetin mbi dymbëdhjetë muaj si “argument”, dhe shtoi: “I pari është Aliu, e i fundit El-Kaimi (Mehdiu shiit).

Duke qenë me kesi komentime qesharake nuk mund të kalojnë te sunninjtë, kanë qenë të detyruar të kërkojnë diçka më të mirë. Prandaj shpikën se ky Kur’ani i sotëm, në realitet,

KUSH JANË SHIJNJTË?

nuk është Kur'ani i vërtetë, porse Ebu Bekri dhe Umeri kanë nxjerrë prej tij çka nuk u ka pëlqye, kurse Kur'anin e vërtet Resulull-llahu s.a.v.s. ia ka kumtuar vetëm Aliut, e ky ua ka dorëzuar pasardhësve të tij, ndërsa ta e ruan imami i dymbëdhjetë “El-Kaimi”, i cili është i fshehur e i gjallë, e kur të paraqitet, do ta sjell me vete. Këtë e quajten “Kur’ani i Fatimes”. Më 2 mars të vitit 1986, me rast manifestimi të ditës së gruas (ditlindja e Fatimes), Humeini ka thënë: “Fatimja ka jetuar 75 dit pas vdekjes të babës së saj, dhe për çdo ditë i vinte Xhibrili për ta njoftuar se çka do të ndodh në të aredhmen!!, e Aliu shënonte (!!) Me sigu se ia ka përmendur edhe ngjarjet në Iran...(!!!) (Njeriu nuk mundet e të mos qesh në kësi budallallëqe, mirëpo masat naive shiite megjithatë këtë e përbijnë).

Në librin më të rëndësishëm rafidij “El-Kafî”, nga Kulejni, ia vëjnë në gojë pasardhësit të Aliut, Xha’fer Sadikut këto fjalë: “Tek ne është ruajtur Kur’ani i Fatimes, sa tre Kur’ana tuaj. Pasha All-llahun, në të nuk ekziston asnjë shkronjë nga Kur’ani i juaj...Dhe tek ne është Xhefri, dituria e të gjithë pejgamberëve dhe trashëgimtarëve të tyre... Dhe tek ne është dituri e çdo gjëje që ka ndodhur dhe çka do të ndodh deri në Ditën e Gjykimit!”

Në librin “El-Envar Nu’manije” (2/360), Ni’metullah El-Xhezairi thotë: “Kur’anin e parë, siç tregojnë kët argumentet e vërteta, nuk e ka tubuar askush përveç Aliut dhe atë sipas kërkesës të të Dërguarit të Zotit. Për tubimin e tij ka qenë i angazhuar gjashtë muaj. Kur e tuboi, ia dërgoi as’habëve, por Umeri i tha: “Nuk na duhet Kur’ani yt, ne e kemi Kur’anin që e ka shënuar Uthmani”. Në këtë Aliu u tha:

KUSH JANË SHIJNJTË?

“Më nuk do ta shihni kurrë, e as që do ta sheh dikush, përderisa nuk vjen pasardhësi im Mehdiu” (imami i dymbëdhjetë “i fshehur”). E ajo se Pejgamberi i ka bërë Uthmanin dhe Muaviun shkruar të Shpalljes, këtë e ka bërë që të mos thonë njerëzit se është duke trilluar! Ata kanë shkruar nga Shpallja vetëm atë që ka sjellur Xhibrili në mesxhid, kurse ajo që ka zbritur nga Shpallja në shtëpinë e të Dërguarit të Zotit, nuk e ka shënuar askush tjetër përveç Aliut (!!). Gjatë kalifatit të vet Umeri ka kërkuar nga Aliu që t’ia tregojë Kur’anin e vërtetë, por Aliu ka refuzuar duke e ditur ze ky do ta ndizte atë (!!). E kur Aliu e morri kalifatin, nuk ka pasur guxim ta tregojë Kur’anin e vërtetë, siç nuk ka guxuar të lejojë martesën e përkohshme, të cilën e ka ndërprerë Umeri. E, nëse pyet, përse është e lejuar të mësohet ky Kur’ani i sotëm, i prishur (Zoti na ruajt) dhe të punohet sipas dispozitave të tij, duhet ta dish se imamët tanë kanë urdhëruar të veprohet kështu gjersa nuk paraqitet Mehdiu, i cili do ta shkëlqejë këtë Kur’an nga duart e njerëzve, do ta sjell atë që e ka shënuar Aliu dhe do të punojë sipas dispozitave të tij (!!)

FOTOGRAFI (faqe 87)

Ekstrakte nga përmbledhja kryesore të deklaratave të ashtuquajtura të imamëve shiitë - “Usulul-Kafi”, nga Kulejnu

(Kaptina)

- Mbi atë se Kur’anin askush nuk e ka tubuar të tërin përveç Imamve -

KUSH JANË SHIJNJTË?

Xhabiri thotë: “Kushdo që konfirmon se e ka tubuar të tërë Kur’anin - është gënjeshhtar. Vetëm Ali Ibni Ebi Talibi e ka tubuar dhe e ka mësuar përmendsh Kur’anin ashtu siç është i shpallur, dhe Imamët pas tij.”

Babai i Xhabitrit thotë: “Askush nuk mund të konfirmojë se posedon të tërë Kur’anin, të dukshmin dhe të fshehurin, përveç Imamëve.”

Rafidinjtë lejojnë “martesën” e përkohshme, për të cilën e akuzojnë Umerin se ua paskësh ndaluar atë. Nuk ekziston ndonjë fe e cila rekomanson prostitucionin (marrëdhënie trupore jashtëmartesore), mirëpo feja e rafidinje jo vetëm që e rekomandon, por as që e konsideron se ka besim të plotë atë që nuk e ushtron këtë, dhe që është me e keqja nga të gjitha, tërë këtë ia vëjnë Resulull-llahut s.a.v.s. në gojë, qofshin të mallkuar!, apo të Aliut dhe pasardhësve të tij. “Martese” e përkohshme, apo “ëndja siç e quajnë ata, është prostitucioni më i thjesht i ligjësuar, pa dëshmitarë, me pagesë përkatëse, dhe për kohë të caktuar, pa pyetjen e gruas se a është e martuar apo jo! Për të gjitha këto, natyrisht, kanë “argumente”, e thonë se i Dërguari i Zotit ka thënë:

“Kush shkon nga dunjallëku duke mos e ushtruar (praktikuar) martesën e përkohshme, vjen i gjymtë (sakat) në Ditën e gjykimit.”

“Kush e praktikon martesën e përkohshme një herë, e ka liruar një të tretën e trupit të vet nga zjarri, kush e praktikon dy herë, i ka liruar dy të tretat, e kush e praktikon tri herë, është liruar i tëri nga zjarri.”

KUSH JANË SHIINJTË?

Mirëpo, edhe nëse është lehtë t'i joshësh meshkujt në kësi lloj feje “ëndjesh” (ndoshta edhe për këtë kanë sukses t'i përvetësojnë injorantët nga sunninjtë), si të binden femrat që t'i ipet tek ashtu kujdo që të arrijnë? Edhe këtë do ta zgjidhim lehtë, duke nxjerrur thjeshtë nga xhepi “hadithin” tjetër të gatshëm të të Dërguarit të Zotit:

“Duke u ngritur në qiell me arrijti Xhibrili e më tha: “O Muhammed, All-llahu i Lartmadhëruar thotë: “Ia kam falur mëkatet grave të ummetit të cilat e praktikojnë martesën e përkohshme” (!!!)

Dhe jo vetëm kaq, por ai që nuk e praktikon këtë, është i padëgjueshëm ndaj All-llahut (!) Ia vëjnë në gojë iamamit të vetë të dhjetit me radhë, se i ka thënë një njeriu i cili e ka pyetur se çka duhet bërë nëse është betuar se nuk do ta praktikojë martesën e përkohshme: “I je betuar All-llahu në padëgjuesë!”

Dhe, nëse nuk e keni ditur, edhe “martesa” e përkohshme ka qenë në Kur'an, porse Umeri e ka anuluar: “I erdhi tezakja njëfarë njeriu nga kurejshët e i tha: “Nuk të erdha ngase më duhet mashkulli, porse kam dëgjuare se Allahu e ka lejuar martesën e përkohshme në Kur'an, dhe e ka vërtetuar i Dërguari i Zotit në Sunnet, kurse Umeri e ka ndaluar, e unë dëshiroj që të jem e dëgjueshme ndaj All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, e e padëgjueshme ndaj Umerit, prandaj më marto përkohësisht! Shkoi njeriu ta pye Xha'fer Sadikun, e ky oi tha: “Bëre atë, All-llahu ju bekoftë!”

E, kush nuk e konsideron të lejuar këtë zinallëk, nuk është prej shiinjve: “Nuk është prej nesh ai që nuk beson në fitoren

KUSH JANË SHIINJTË?

tonë përfundimtarëve (mbi sunninjtë) dhe kush nuk e konsideron të lejuar martesën e përkohshme.”

Shiinjtë e kanë ëndje mishin e ri, andaj u kujdesën edhe për “argument”, të cilën ia vënë në gojë iamamit të pestë Bakirit: Një njeri e kishte pyetur se sa e re mund të jetë femra për martesë të përkohshme, e ky përgjigjet: “Nëse nuk mund të mashtrohet!” Njeriu e pyet: “E prej kur nuk mund të mashtrohet?” E Bakiri i përgjigjet: “Kur është në moshën dhjetëvjeçare (!)

Myslimani nuk mund t’i ketë njëkohësisht më tepër se katër gra të vërteta, e të përkohshme? Ja përsëri Xha’feri: “Martohu me një mijë nëse dëshiron, sepse ato janë me qira.” E, a mund të goditen për një marrëdhënie? Nuk ka çka nuk bëhet: “Bëhet”, gjoja se thotë imami i dhjetë Ebu Hasani, por, kur e kryen punën duhet ta kthejë kokën e mos ta shikojë “bashkëshorten”!

E çka duhet bërë nëse goditemi për dhjetë ditë “martese”, e “nusja” nuk më vjen pos pesë ditë, e unë i kam paguar dhjetë dirhem? Nxirre përsëri Ebu Hasanin të të thotë se “nusja” duhet të t’i kthejë dhjetë dirhem të cilat i ka përvetësuar në mënyrë të “pandershme”!

E tërë kjo është lehtë. Por çka duhet bërë nëse ndodhë fimijë? Mos u merakos: “Fëmija nga “kënaqësia” është më i mirë se fëmija nga martesa”(!), “thotë” Xha’feri.

Që nga ardhja e homeinjve ka mar hov “martesa” e përkohshme. Gjer në vitin 1993 janë lindur 300.000 kopila!!

Më pëlqen robëresha e jaranit. A mund të ma huazosh? “S’ka problem”, përsëri nga goja e Ebu Hasanit.

Porse shejtani nuk të lë të qetë. Më është mërzhitur në mënyrë natyrale, a mundet ashtu siç bëjnë homoseksualët? “Nuk ka pengesa!” (Përsëri Xha’feri!) E çka të bëjmë me ajetin kur’anor: **“Afrohi atyre prej nga u ka udhëruar All-llahu.”** (El-Bekare: 222).

Këtë Xha’feri i ndjer do të na shpjegojë shpejtë: “Kjo ka të bëjë kur dëshiron fëmijë”(!!)

Ta lëmë talljen mënjanë, shpresoj se bile ky fakt, nëse jo diç tjetër, do t’i largojë vajzat tona të martohen me shiinjtë, të huaj dhe të vendit. Por, hajt e dije se është shiit! S’ka zgjidhje tjetër, motër, pos të kuptosh se prej nga është, e nëse është nga Irani, Iraku, Libani, sipas të gjitha gjasave është shiit! Por mund të gënjejë, e mund të jetë edhe shiit i poshpjekur, madje mund të jetë edhe boshnjak (ose shqiptar sh.p.). Nëse pak dyshon, përpiku ta kundrosh kur falet vetëm, a do të falet në lëkurëz apo në sexhade, e nëse nuk do, atëherë është shiit, pasi që ata falen vetëm në tokë apo në diç që ka ka preardhje nga toka: në hasure, në dru, ose së paku në faqe të letrës. Pastaj informohu se a e falë akshamin me kohë, apo e vonon, pasi që ata e falin akshamin më vonë dhe gjithnjë e bashkojnë me jaci (përveç nëse nuk janë të detyruar të shtiren). Pastaj kuptoja emrin, e nëse diku në emër ka Abdul Husein (rob i Huseinit), Kazzum, Bakir, Xha’fer, Sejjid, Ali, Hasan, Husein, ke kujdes! Nëse quhet Umer, Uthman, Zubejr, Talha, Muavije, atëherë me siguri nuk është shiit! Përpiku të kuptosh se a i lanë këmbët, apo vetëm i fërkon pak këmbët e zbathura. Nëse pas të gjithash nuk je e sigurtë se nuk është shiit, atëherë më mirë mos u marto!

E nëse më pëlqen ndonjëra, porse nuk e diç se a është e martuar? “Mos merr hetime!” (I ndjeri Xha’fer).

E, nëse nuk mund të has në ndonjëren që nuk pajtohet, a mun ta “martoj” përkohësisht laviren? “Po, si jo!”, thotë i njohuri i jonë Homeini... e me këtë e pengon nga mbrapshtia”!! E përse i përket kohëzgjatjes së “martesës”, mundet edhe një natë, apo një orë!! E, pasi që iu kthyem Homeinit, t’i kthehemi përsëri temës nga e cila për një çast u larguam, mbi Kur’anin e “vërtetë”. Në librin e vet “Hukuma Islamijje” (Pushteti Islam, faqe 66)) me respekt të veçant përmend Nuri Terbesiun, ndërsa ky Tebersi në librin “Fastul hitab” përmend një faqe të tërë “të vjedhur” nga Kur’ani “i vërtetë”, me emrin “Velaje”, e cila fillon kështu: **(TEKSTI ARAB)** “O ju që besuat, besoni në Pejgamberin dhe në trashëgimtarin e tij, të cilët u dërguam juve që t’ju udhëzojnë në rrugën e drejtë.”

FOTOGRAFI (faqe 92)

“Kaptina” e trilluar kur’anore “Vilaje” me përkthimin persian ndërmjet reshtave

“Usulul-kafi” i Kulejnit: “Kur’ani të cilin e ka sjellur Xhibrili i ka shtatëmbëdhjetë mijë ajete” (I yni i ka “vetëm” mbi gjashtë mijë ajete)

Dijetari i dytë shiit Mexhlisi, të cilin e Homeini në librin e vet “Keshful esrar” (f. 121), e lavdëron dhe rekomandon të lexohen librat e tij, e veçanërisht “Hakkul jekin, konfirmon se Uthmani, kalifi i tretë, nga Kur’ani i ka mënjanuar tri gjëra: gradat e larta të Aliut dhe të pasardhësve të tij, qortimin e kurejshve, dhe qortimin e tre kalifëve të parë, siç është “ajeti”: **(TEKSTI ARAB)** “Sikur të kishte dashur Zoti e mos te mirja Ebu Bekrin për shok!” Ndërsa në librin të rekomanduar nga

KUSH JANË SHIINJTË?

Homeini “Hakul jekin” Mexhlisi na rrëfen se Xha’fer Sadiku ka thënë se imami i dymbëdhjetë Mehdiu që është i fshehur, kur të paraqitet, do të shkojë në Mekë e pastaj në Medinë, ku do të kërkojë të zhvarrosen Ebu Bekri dhe Umeri nga varret e tyre afër të Dërguarit të Zotit dhe të varen në një dru të tharë. Atëherë ky dry do të gjethësohet dhe do të degëzohet, e njerëzit nga të gjitha anët do të vijnë të shohin këtë mrekulli, pastaj Mehdiu do t’i ndajë ata në dy grupe: në ata të cilët i dojnë këta dy dhe në ata të cilët i mallkojnë këta. Pastaj do ti thotë grupit të parë: “Hiqni dorë nga këta dy, se përndryshe All-llahu do të lëshon mbi ju një dënim”, e ata do të refuzojnë dhe heqin dorë nga ai dhe nga ata që e shoqërojnë atë. Mehdiu do të dërgojë në ta një stuhi të zezë e cila do t’i mbysë që të gjithë, pastaj do t’i ringjallë Ebu Bekrin dhe Umerin që të përgjigjen për të gjitha padrejtësitë që i ngjanë shiinjve, dhe çdo shiit do të hakmarret në ta, e pastaj Mehdiu do të urdhërojë që të kryqëzohen në drydhe do t’i djegë ata e hirin e tyre do ta hedhë në lum.!!

Ndërsa për ajetin kur’anor: ***“Luftoni të gjithë kundër idhujtarëve, ashtu si luftojnë ata të gjitha kundër jush.”*** rafidinjtë thonë se komentimi është i fshehur te Mehdiu i tyre, i cili kur të paraqitet do ta sqaroj atë tërësisht, e tërë këtë ia vejnë në gojë imami të pestë Bakirit. Kur benjamini i Homeinit, Mexhlisi transmeton në librin e vet “Hakul jekin” si si do ta sqarojë këtë Mehdiu: “Kur të paraqitet Mehdiu, më së pari do të fillojë t’i pastrojë hesapet e veta me sunninjtë, veçanërisht me ulemanë e tyre, para kafirëve të tjerë, e pastaj do t’i mbytë që të gjithë gjer tek i fundit” E mor Homein, ku janë tani përrallat tua për bashkimin e myslimanëve?

Në librin “Keshful esrar” (f. 138) Homeini e thotë fjalën e vet për shtrembërimin e Kur’anit nga ana e Ebu Bekrit dhe Umerit: “Ebu Bekri e ka trilluar hadithin mbi atë se pejgambërt nuk trashëgohen, ndërsa për Umerin nuk ka qenë vështirë të thotë se edhe All-llahu edhe Xhibrili edhe Pejgamberi kanë gabuar në zbritjen e ajeteve për vilajetin e Aliut, kurse sunninjtë e përkrahin atë siç e përkrahën edhe më parë kur e ndryshonte fenë islame, dhe fjalëve të tij i kanë dhënë përparësi ndaj ajeteve Kur’anore”.

Hadithi që e përmend Homeini, janë fjalët e Resulull-llahut s.a.v.s.: **(TEKSTI ARAB)** *“Ne pejgamberët nuk lëmë trashëgime, e çka mbetet pas nesh (nga pasuria) ndahet për sadaka.”*

Rafidinjtë e akuzojnë Ebu Bekrin se këtë hadith e ka trilluar për ta penguar Fatimen të gëzojë të drjtën në trashëgimi. Homeini do të dëshironte të argumentoj se në ç’mënyrë është trilluar hadithi, andaj e citon ajetin kur’anor: *“E Sulejmani e trashëgoi Davudin”* (El-Neml: 16). (Natyrisht, ajeti nuk flet trashëgimin e pronës, por për pejgamberllëk dhe udhëheqjen e popullit).

Pastaj Homeini përmend kundërshtimin e Umerit dispozitave kur’anore (!), e thotë: “Po e theksoj kundërshtimin e Umerit civateve kur’anore, në mënyrë që të provojë se kundërshtimi i Kur’anit nga ana e tyre është punë tejet e lehtë, prandaj me siguri do ta kundërshtojnë Kur’anin nëse në të përmendet vilajeti i Aliut.” Pastaj ia sheh për të madhe Umerit që ua ka anuluar “martesën” e përkohshme. Për këtë arsye Homeini i quan Ebu Bekrin dhe Umerin “idole të kurejshve”,

dhe kërkon mallkimin e tyre, si dhe vajzave të tyre Aishes dhe Hafses, bashkëshorteve të Resulull-llahut s.a.v.s.!

Në “Tuhfetil avamil makbul” (f. 422) Homeni ka kumtuar, së bashku me duatë e tjera edhe tekstin e duasë kundër këtyre dy kalifëve: “O All-llahu im, mallkoi ata, edhe ithtarët e tyre, edhe ata që i duan ata, se e shkatërroan shtëpinë e Pejgamberit, dhe i shfarosën ithtarët e tij, dhe ia mbytën fëmijët, dhe e lanë mimberin e tij të zbrazët pa trashëgimtar, lëri ata përgjithmonë në zjarr!”

Kështu Homeini jonë vepron ndryshe nga ajo që flet. Rafidinjtë u mbetet problemi se Ebu Bekri është përmendur në vetë Kur'anin, ku flitet mbi memontin kur, të strukur në shpellë, Resulull-llahu s.a.v.s. dhe Ebu Bekri i shohin ndjekësit e tyre para shpelle: **“Kur këta të dy ishin në shpellë, e kur i tha shokut të vet: “Mos u mërzi! Seë, All-llahu, me të vërtetë është me ne!”** (Et-Tevbe: 40).

Rafidinjtë këtë ajet e shpjegojnë në këtë mënyrë: po “me ne” do të thotë “me mua dhe Aliun”(!!!)

Një çështje tjetër është e mundimshme për ta: si u bë që Aliu e ka dhënë vajzën e vet Ummu Kulsumen për Umerin?

Ravindi në librin “Mevaiz Huseinije” thotë se Aliu e ka shëndruar xhinnin femër në vajzën e vet, e Ummu Kulsumja në realitet ka mbetur e pamartuar(!)

Ndërkaq, Kulejni në “Furu’ Kafi” pohon se Umeri nuk e ka martuar Ummu Kulsumen, porse e ka grabitur atë dhe e ka dhunuar!

Kurse Ni'metullah El-Xhezairi pohon se Aliu ka qenë i detyruar ta japë vajzën ngase Abbasi, xhaxhai i të Dërguarit të Zotit, iu është kërcënuar me vrasje!

Për këtë shkak, për nder të vrasësit të Umerit, persianit Lu'lu (e ka mbytur derisa e udhëhiqte namazin e sabahut), i cili meriton “mëshirën” e All-llahut, ngase e ka mbytur Umerin pas mallkimit të Pejgamberit dhe Fatimes, i festojnë tri ditë (9-11 rebiul-evvel), dhe atëherë u është urdhëruar engjëjve që të mos i shkruajnë mëkatet, e shiijnjtë mund të bëjnë çka të dojnë gjatë këtyre tre ditëve! Kështu flet benjamini i Homeinit Mexhlisi në “Zadul Mea’d” (f. 433). Kurse në një libër tjetër të tij, “Hajatul Kutub” (2/870), nuk kanë kaluar më mirë as Aishja as Hafsa, bashkëshortet e ndershme të Resulull-llahut s.a.v.s. (por edhe vajzat e Ebu Bekrit dhe Umerit). Përkatësisht, Mexhlisi i akuzon se në marrëveshje me babalarët e tyre e kanë helmuar Pejgamberin, e për këtë shkak ai është shehid (!!!)

Sipas tyre të gjithë shokët e të Dërguarit të Zotit kanë reneguar nga feja pas vdekjes së tij, duke mos e pranuar Aliun për trashëgimtar. Në librin “Ihtijar ma’rife” (I/6) të Nasiruddin Tusiut, i cili i patë ftuar mongolët që ta sulmojnë Bagdadin, kryeqendrën e shtetit sunnit, e të cilin Homeini e lavdëron në librin e vet “Qeveria Islame” (f. 128), i vihet në gojë imamet të pestë tefsiri i ajetit kur’anor: **“Muhammedi është vetëm Pejgamber. Por, edhe para tij ka pasur Pejgamberë. E, nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa?”**, se as’habët janë kthyer nga feja pas vdekjes së Pejgamberit (!) (Ajeti ka zbritur gjatë kohës së betejës në Uhud, kur u pat përhapur lajmi se Resulull-llahu s.a.v.s. ishte vrarë).

FOTOGRAFI

(faqe 98) - **“Bahrul-envar-i” i Mexhlisiut** - *“Munafikët të cilët kanë qenë të pranishëm kur Pejgamberi e shpall Aliun për*

KUSH JANË SHIJNTË?

trashëgimtar: Ebu Bekri, Abdurrahman Ibni Avfi, Sa'd Ibni Ebi Vekkasi, Ebu Ubejde..."

(faqe 99) - *Faqet nga libri i Homeinit "Keshful-esrar në persishte, në të cilat thotë se Pejgamberi para vdekjes është frikësuar të shpall trashëgiminë e Aliut.*

(faqe 100) - *Ebu Bekri akuzohet për kundërshton Kur'anit*

(faqe 101) - *Umeri akuzohet për kundërshton Kur'anit*

Tani t'i kthehemi rrjedhës së ngjarjes. Kur dëgjon Aliu se ekzistojnë njerëz që e konsiderojnë më të mirë se Ebu Bekrin, urdhëroi që të rrahen me kamxhik, siç kishte bërë para tij edhe Umeri me ata të cilët e konsideronin më të mirë se Ebu Bekrin. Aliu dëgjojë edhe për ngatërrestarin Abdullah Ibni Seba'n dhe se ky e shante Ebu Bekrin dhe Umerin, e kërkojë që ta mbyste, ndërsa ky iku larg tij. Asokohe këtij i shkon për dore që edhe më tej ta përpunojë planin e vet, dhe e shpallë Aliun për hyjni. Çdonjërin që e zinte prej të këtillëve, Aliu urdhëronte që të ndizet për së gjalli.

Muaviu kërkonte që t'i dorëzohen vrasësit e Uthmanit, kushërit të tij, ndërsa ali e zëvendësoi nga posti i mëkëmbësit të Sirisë. Disa nga as'habët kaluan në anën e Aliut e disa të tjerë në anën e Muaviut, kurse më së miri vepruan ata që mbetën neutral. U shkaktua një luftë e re dhe e madhe në Siffin, ku u vranë shumë njerëz, andaj vendosët që konfliktin ta zgjidhin në mënyrë paqësore dhe caktuan një afat për negociatë. Kjo shkaktoi që një grup nga ushtria e Aliut të ngriten kundër Aliut, të cilin e shpallën kafir për shkak se pranoi negociatat. Gjithashtu edhe Muaviun e shpallën kafir sikurse edhe të gjithë ata që qëndruan në anën e Aliut apo të

KUSH JANË SHIINJTË?

Muaviut, ndërsa ata që mbetën të painkuadruar i konsidoronin për mysliman. Këta kanë qenë havarixhinjtë e parë, të cilët i kemi përmendur më herët.

Pas luftimeve të gjata, Aliut i shkon për dore t'i ngadhënjejë, por ia dërguan një atentatorë e cili e mbytë kurse atentaori tjetër që ishte caktuar që ta mbysë Muaviun nuk pati sukses ta kryejë deyrën e vet. Iraku e shpalli Hasanin, djalin e Alit, për kalif të ri, por shtetet e tjera myslimane ishin për Muaviun, andaj Hasani i lëshoi kalifatin Muaviut, në mënyrë që t'i pengojë konfliktet e re, duke i njëmëndësuar fjalër e Resulull-llahut s.a.v.s.: **(TEKSTI ARAB)** - *“Ky, biri im, është i pari! Ndoshta me ndërmjetësimin e këtij All-llahu do t'i pajtojë dy grupet e muslimanëve.”*

Muaviu ishte në dilemë se çka do të bëjë me trashëgimtar pas vdekjes së tij, pasi që kishte shumë fëmijë të as'habëve të denjë për postin e kalifit, e kjo do të mund të shkaktojë fitne. Prandaj vendosi që deri sa ishte gjallë ta marrë zotimin për djalin e vet Jezidin, i cili ishte i dashur nga të gjithë në sajë të heroizmit të tij në luftërat me bizantinët dhe për shkak të modestisë së tij. Mirëpo, djali i dytë i Aliut, Huseini e ndjeu se ishte i dëmtuar, andaj kur u ftuar nga ana e shiinjve irakian që t'u bëhet kalif, vendosi të marrë rrugë së bashku me familjen e vet. Ndërkaq shiinjët e tradhtuan dhe qe i prerë nga ana e mëkëmbësit të Jezidit. I dhjeti muharrem, dita e vrasjes së huseinit në Kerbela, është dita kur rafidinjtë e frushkullojnë vetveten dhe prehen nëpër kokë për shkak të tradhtisë që ia përgatitën Huseinit.

FOTOGRAFI

(faqe 104)

KUSH JANË SHIINJTË?

Shiinjtë e vajtojnë vdekjen e Huseinit duke e goditur vetveten me thika në kokë.

Thotë Homeini në Testament: “Dijeni se mallkimi i amshuar i Umevijve, qofshin të mallkuar nga All-llahu , paraqet dëbimin e tiranëve të botës. Është e paevitueshme që të publikohen veprat e këqija tiranike të tyre përmes ceremonive vajtimi për Imamët.”

(faqe 105) - *Shfaqjet mbi ndodhitë në Kerbela nëpër fshtërat shiite kultivojnë urrejtjen ndaj sunninjve*

Fetvaja e nënshkruar nga ana e udhëheqësve fetar bashkohor shiinj, ndër të cilët edhe Homeini dhe Sheriat Madari, në të cilën kërkohet nga masat shiinje të mallkohen Ebu Bekri dhe Umeri.

(faqe 106)- *Në ballë të të “pikëlluarve” qëndron: “Aliu është më i madhi”*

Më vdekjen e huseinit fillon lëvizja refidinje, e cila do të kurorëzohet me kryngritje kundër Umevinjve në Horasan, e cila do të sjellë rrëzimin e tyre. Mirëpo, kur rafidinjtë dëshiruan t’ia dorëzojnë kalifatin Xha’fer Sadikut, të cilin ata e konsiderojnë për imam të gjashtë të tyre, ky refuzon, sikurse edhe pasardhësit e tjerë të Aliut, kështi që kalifati mirret nga ana e xhaxhait të Resulull-llahut s.a.v.s., Abbasit. Xhaferi, të cilit rafidinjtë në mënyrë të paturpshëm ia mvishnin falsifikimet e veta, thoshte për Ebu Bekrin se këtë e ka baba të dyfishtë, ngase nëna e tij ishte stërmbesa e Ebu bekrit nga ana e babait dhe nga ana e nënës. Amir Ibni Kajs El-Mulai transmeton fjalët e Xha’ferit: **(TEKSTI ARABISHT)** ”Heqtë dorë All-llahu nga ai i cili heq dorë nga Ebu Bekri.”

KUSH JANË SHIINJTË?

Në kohën e Xha'ferit përhapet lajmi mbi njerëzit e pagabuar, imamët e caktuar nga All-llahu, nga ana e Shejtan-Taka Rafidiut, të cilit këtë dogmë ia kundërshtonin Xha'feri dhe xhaxhai i tij Zejd Ibni Aliu. Pasardhësi i parë i Aliut, që bie nën ndikimin e propagandës së tyre, ishte djali i Xha'ferit Ismaili, nga cili babai i tij heq dorë. Siopas tij janë quajtur Ismailinjtë - për të cilit tanimë kemi folur. Duke e pritur për çdo ditë para një grope në tokë në qutetin Samarra të Irakut, imamin e tyre, ata ia sjellin një kalë për t'i hipur duke ia drejtuar duanë "Dil, o imam!" Kështu të gjithë e presin imamin e tyre, sikurse hebrenjtë që e presin Mesium e tyre (pasi nuk e kanë pranuar Isain a.s.) dhe të gjithë së bashku do ta presin Dexhxxhallin e të shkojnë pas tij.

Resulull-llahu s.a.v.s. na informon se ushtria e Dexhxxhallit do të jetë e përbërë nga Hebrenjtë persianë, e tanimë e kemi përmendur sekretarin e Resulull-llahut s.a.v.s. Hudhejfen, i cili thotë se Dexhxxhallin do ta pasojnë të gjithë ata që në zemër bartin miratimin e vrasjes së Uthmanit. Siç thotë Ibni Tejmiu, feja e rafidinjeve me të vërtetë i ngjanë për shumë gjëra fesë hebrenje, siw është parimi i shtirjes, parimi i trashëgimit të imametit, komentimin e shtrembëruar të Shpalljes, vonimin e namazit të akshamit dhe të iftarit - sikurse sekti hebrenj Samira, ndalesës së mishit i cili nuk është prerë nga ata...

Myslimanët, nën udhëheqjen e Mehdi Muhammedit djalit të Abdullahut, siç na informon Resulull-llahu s.a.v.s., do ta ngadhënjëjnë ushtrinë e madhe të krishterëve, e cila do të numëron afro një milion ushtarë, në betejën te Damasku, e pastaj do të hyjnë në Romë, ku do të pranojnë lajmin për paraqitjen e Dexhxxhallit me ç'rast do të kthehen përsëri. Gjatë

KUSH JANË SHIJNJË?

kohës së Dexhxxhallit myslimanët do ta popullësojnë vetëm edhe Irakun, Siujdhesën Arabike dhe Shamin (Siria, Jordani dhe Palestina). Dexhalli dhe ushtria e tij i bien së pari Irakut, pastaj Siujdhesës Arabike, e pasta Shomit. Mehdiu dhe ushtria e tij do të gjenden në kodrat e Jordanit, ku u vjen Isai a.s. dhe do fillojnë luftën me Dexhxxhallin dhe ushtrinë e tij - muslimanët në anën lindorë ndërsa Dexhalli me ushtrinë e vet në anën perëndimore të lumit Jordan. Në luftë e sipër do të flasin edhe gurtë edhe drunjtë, duke tregur se dnonjë hebreq është fshehur pas tyre. Isai do ta mbyllë Dexhxxhallin, ndërsa ushtria myslimane do të ngadhënjejë. Këto tanimë do të jenë parashenjat e Ditës së gjykimit. Mirëpo gjer atëher na mbetet të davaritemi me rafidinjtë, siç dimë më së miri, e, sa më mirë t'i njohim ata, më mirë edhe do të dijmë

Edhe dymbëdhjetëimaminjtë kanë zhvilluar filozofinë e vet mby imametin dhe kanë filluar t'i konsiderojnë imamët si paraqitje të drejtëpërdrejtë të Zotit. Në librin e vet "Misbahul-hidaje" (Feneri i udhëzimit) (më mirë do t'i kishte hije emri "Errësira e lajthitjes", Homeini rrëfen marrëzira të njëjta, çfarë i hasim tek ismailinjtë, filozofët dhe sufinjtë, e para tyre te të krishterët, e para këtyre te gnostikët dhe neoplatonistët.

E ka shkruar derisa ligjëronte filozofinë e sufizmit, dhe në të përsëritë këngën e njëjtë të Ibni Arebiut (shejhu më i madh sufist), të cilën ky përsëri e ka marrë nga filozofët panteist grek, ku thuhet se Zoti dhe bota e dukshme të cilën e ka krijuar Ai në realitet janë vetëm dy fytyra të një realiteti, "sikur që dritën e shohim në ngjyra të ndryshme përmes një cope xhami të bojatisur." (!?) All-llahu më së para paraqitet në Vetën e Vet

për Veten e Vet. Mandej fillon të emanojë (pasqyrohet, reflektohet) (tanimë këtë e kemi hasur në filozofi) me anë të përfaqësuesit të Vet, që ka Arsye të Përsosur (edhe këtë e kemi hasur te gnostikët, te krishterim ose te ismailinjtë). Kjo Arsye shfaqet përmes Emrave të mishëruara të Zotit. Çdo i Dërguar i Zotit është mishërim i njërit nga emrat e Zotit, kurse i Dërguari i fundit i Zotit është mishërim i emrit All-llah, i cili përfshinë të gjithë emrat e Zotit, kështu që në formën e Muhammedit është paraqitur njëmendshmëria e tërë ekzistenciale dhe i tërë Islami i shpallur.

Pra, Muhammedi Intelikti Universal (Arsyeja e Gjithmbarshme), prototip i njeriut, ndërsa të gjithë të Dërguarit e mëparshëm kanë marrë konceptin (njohurinë) nga njëmendshmëria e Muhammedit (ky është përshkrim tekstual nga Ibni Arebiu, dhe nga shiiu-sufiu më i vonshëm Mulla Sadri), pasi që Muhammedi është krijesa e parë që është krujuar.

Në fund Homeini këto premisa, të njohura që më parë, i erëzon me aromë shiite. Sipas tij shpirti i Aliut ka qenë i bashkuar me atë të Muhammedit s.a.v.s., dhe që të dy kanë qenë Dritë e Zotit. Dhe, jo vetëm e Aliut, por edhe e të gjithë të dymbëdhjetë imamëve të tjerë. Për herë të fundit Drita e Zotit është derdhur në imamin “e papranishëm” të dymbëdhjetë, përmes të cilët përsëri do të shfaqet Përsosuria e Zotit, Emrat e Tij dhe Veçoritë Tij.

Mirëpo, ëmbëlsirën e kemi lënë për fund: “Sikur të ishte lindur Aliu më parë, ai do të ishte Pejgamber” (!!!)

FOTOGRAFI

(faqe 110)

-Imamët e dijnë se kur do të vdesin dhe vdesin atëherë kur zgjedhin vet -

- Imamët e dijnë se çka ka ndodhur dhe çka do të ndodhë dhe asgjë nuk u është e fshehtë -

“USULUL-KAFI”, Kulejni

(faqe 111)

Nga libri i Homeinit “Pushteti islam” (përkthyer nga ana e Ambasadës Iraniane në Beograd)

Homeini më tej na mëson se si edhe njerëzit e thjeshtë mund të arrijnë “Diturinë e përsosur”, e kjo është “të kuptuarit” se çdo gjë që ekziston është Vetë Zoti, dhe të hyjë në “Qytetin e diturisë” e të përjetojë Bashkimin me Zotin. Atëherë bëhet i vetëdijshëm për esencën e të gjitha gjërave dhe din e sheh atë që të tjerët nuk mund të dinë e të shohin.

Homeini ka pohuar për vetveten se e ka arritur këtë, kurse studentët e vet i ka porositur që për keto gjëra të mos u flasin studentëve të tjerë, me pretekst se ata “do të mundën t’i kuptojnë gabimisht”

Pra, këtu shohim se si Homeini shërbehet me metodën e njëjtë, me çfarë janë shërbyer edhe shehlerët dervishë ndaj ithtarëve të tyre, prej të cilëve gjithashtu kërkojnë që të ruajnë “fshehtësinë”. Dhe, me të vërtetë, me kesi lloj budallallëqesh nuk mund të përvetësohen njerëz tjerë pos budallenjët dhe injorantët, çfarë janë shumica e madhe e shiinjve, e poashtu edhe dervishësh në botë. Përkatesisht, nga e tërë kjo ata nuk kuptojnë asgjë, porse ndiejnë frikërrespekt para këtyre fjalëve të mëdha, dhe, pasi që është fjala për personalitete të dobëta të nevojshëm për prijës, i lëshohen pasimit të verbër të shehlerëve

KUSH JANË SHIJNJTË?

të tyre mendjemëdhenj, të cilët edhe ata kanë gjetur ajo që u nevojitet - dikë që t'i pasojë. Mjerisht, me kësi lloj shpirtërash është kehtë të manipulohet, dhe të drejtohen në flijim e jetës, pasurisë dhe tërë atë që posedojnë, për qëllimet e sëmura të prijesve të tyre.

Lloji i dytë i njerëzve që mund t'i përgjigjen këtyre frazave të zbaritura, janë ata të cilëve u përgjigjet ndasia e thjeshtë në Islamin burimor: në Krijuesin-Sunduesin dhe Krijesat-Robërit. Në kësi formulash dhe konstruksionesh gjejnë atë që do të mund tua kënaqë mendjelehtësinë e tyre - “Njerëzit e përkryer”, “Dituria e përkryer”, e të ngjashme. Është me rëndësi vetëm që të jenë mbi njerëzit e rëndomtë. Nuk ka thënë më kotë Resulull-llahu s.a.v.s.: **(TEKSTI ARAB)** “*“Nuk do të hyjë në Xhennet kush ka në zemrën e tij sa një kokërr (atom) mendjemadhësi”*”

Për t'i vërtetuar këto mjegullnaja, Homeini shërbehet me “hadithe” të trilluara që i përshkruhen Resulull-llahut s.a.v.s., prej të cilëve shumica përsëri mund t'i hasni në hallkat e dervishëve tanë, siç janë:

“Une jamë kështjellë e diturisë, e Aliu është porta e saj.”

“Kush e koncepton veten, e ka konceptuar Sunduesin e vet.”

“All-llahu nuk ka ktijuar asgjë pos meje.”

Në fillim ka qenë drita ime.”

ose të përshkruara Aliut:

“Ju mendoni se jeni një trup i vogël, porse në ju është e fshehur tërë bota.”

Unë kam qenë me të dërguarit fshehurazi, e me Muhammedin haptazi.”

KUSH JANË SHIJTË?

Më vonë Homeini do t'i shfrytëzojë mirë këto konfirmime mbi posedimin e "Diturisë së përkryer" që të emërohet si prijës "zëvendës i Imamit të fshehur", ndërsa "rojtaret" e tij "të revolucionit" do ta heshtin çdo alim shiit, i cili nuk pajtohet me këtë, siç i ka ndodhur Sheriat Madariut, i cili ka qenë i kërcënuar madje edhe me nderin e vajzës së tij, siç na rrëfen Doktor Musa Musevi, emër i famshëm shiit në ditët e sotme në librin "Thevra Baise" (Revolucioni fatkeq). Këtë libër ia rekomandojmë çdonjërit që dëshiron të dijë të vërtetën mbi revolucionin e Iranit nga dora e parë dhe nga dëshmitari më i afërt i ngjarjeve dhe të gjitha atyre që i kanë paraprirë këtij.

Ai na shkruan me hidhësirë për Homeinin si krijesë medjemadh dhe egoist i pamasë, i cili refuzon ofertën e Irakut që konflikti të zgjidhet në mënyrë paqësore, vetëm nga shkakut se gjatë kohës së persekutimit të Homeinin nga Iraku, gjatë periudhës së Shahut, është kërkuar nga ai të vendoset ndërmjet asaj që ta ndëprejë të folurit kundër qeverisë iraniane dhe daljes nga Iraku, dhe i cili refuzon edhe ofertën e dytë e të njëjtë nga ana e Irakut, gjatë kohës së hyrjes të ushtrisë izraelite në Liban në vitin 1982, në mënyrë që Iraku të mund t'i ndihmoi Libanit, me çrast Homeini i është drejtuar opinionit të gjerë duke deklaruar se lufta kundër Irakut është shumë më e rëndësishme se lufta me Izraelin!!!

Pas kësaj deklarate të Homeinit, mjetet iraniane të informimit mbetën të shrdhër.

Autori na flet për fëmijët që dërgohen të shkelin nëpër mina për t'ua pastruar rrugën tanksave, me çelësa të varur në qafë për hyrje në Xhennet, (ide kjo e huazuar nga Papa Gregori, i cili i dërgonte kryqëtarët në luftë kundër

myslimanëve me qelësa të parajsës rreth qafës); mbi zullumet e “Rojtarëve të revolucionit” të tij, të cilët i dhunojnë të burgosurat para likuidimit, në mënyrë që të mos shkojnë të virgjëra në botën tjetër, duke qenë se hoxhallarët e tyre i mësojnë që virgjëreshat nuk shkojnë në zjarr, e pastaj shkojnë te prindërit e vajzave të pushkatuara me diç të holla dhe ua sqarojnë shkakun e dhunimit të vajzave të tyre, duke i quajtur paratë meher të “martesës së përkohëshme”.

Mbi gënjeshttrat e pabesueshme të mas-medijëve iranianë, sipas të cilëve irakianët do të humbnin më tepër aeorplanë se sa posedojnë Britania dhe Franca së bashku, tankësa më tepër se sa posedon Rusia dhe të gjitha shtetet evropiane së bashku.

Mbi parashikimet qesharake të kryetarit me “Dituri të përkryer”, mbi atë se Bagdati do të bie në afat prej katër orësh (!), dhe se Shahu do të jetë i kthyer në Iran për t’u gjykuar.

Mbi furnizimin e Iran me armë izraelite gjatë luftës kundër Irakut, fakt ky që Homeni plodhshëm e mohonte, gjersa turpi nuk doli në shesh, me çrast deklaroi se “do të merrte armë edhe nga vetë Shejtani nëse do të jetë i detyruar”.

Mbi vrasjen e dhjeta mijëve sunninj në krahinat kyengritëse të Kurdistanit, Arabistanit dhe Beluçistanit pa gjykim.

Mbi lutjen drejtuar Homeinit që ta ndërprejë pushkatimin e pubertetljinjve dhe pleqëve nëpër Iran, në çka ai përgjigjet: “Vritni prijësit e kufrit!”

Mbi kyçjen e emrit të Homeinit në ezan pas ardhjes së tij në pushtet, në mënyrë që pas “All-llahu Ekber!” të përmendet “Homeini Rehber” (Homeini është prijës).

Për të prurët e salavatit të trefishtë pas përmedjes së emrit të Homeinit.

Më tej autori na rrëfen se si herën e fundit, kur ishte takuar me Homeinin kishte kërkuar prej tij që t'i përmirësojë marrëdhëniet me fqinjët, e Homeini i ishte përgjigjur se popujt fqinj shpresoj që revolucioni iranian do t'i liroi nga sundimtarët e tyre dhe se ai nuk mund të përshëndet dorë për dorë me sundimtarë të tillë, në çka autori ynë e pyet se a është i kënaqur populli i Srisë dhe i Libanit me sundimtarët e tyre, dhe si i lejon vetes që të përshëndetet dorë për dorë me ta? “Nghyra e fytyrës së Homeinit u ndryshua dhe ai mbeti i heshtur.” Prandaj nuk kemi se çka të çuditemi nga Homeinin, thotë autori ynë, përse partinë BAAS në Irak e quan parti kafirësh, ndërsa me të njëjtën parti pushtetmbajtëse në Siri kultivon marrëdhënie miqësore.

Pastaj autori na rrëfen se si shpërtheu turpi i madh diplomatik, kur dhëndri i Homeinit dhe kandidati për president të Irakut, Sadik Tabatabai në vitin 1993 u zu në aeroportin e Dizeldorfit me një valixhe përplotë me opium, në çka Irani u kërcënua me ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike, andaj gjrmanët e liruan, e Homeini i priti në aeroportin e Teheranit, në mënyrë që të nesërmen radio-irani të informojë për varjen e njëmbëdhjetë kontrabandistëve me drogë.

Mbi “Gardën revolucionar” të Homeinit, e cilë hyn natë nëpër shtëpia duke i dhunuar vajzat para syve të prindërve dhe gratë para syve të burrave, dhe maltretimin e foshnjave në gji para syve të nënave për të marrë pranimin e fajeve të veta.

Mbi fetvanë e Homeinit për marrjen e gjakut nga të burgosurit para likuidimit.

Mbi kryengritjen e prindërve kundër marrjes së fëmijëve në front me Irakun, kur bartin transpaente në të cilat shkruante: “Nëse kjo është vdekje në rrugën e Zotit, dhe çelësat e Xhennetit, përse atëherë Homeini nuk i dërgon djemtë e vet?”, në çka Homeini lëshon një fetva se fëmijët mund të shkojnë në front pa lejen e prindërve.

Homeini nuk u tregua se kishte “Dituri të përkryer” edhe atëherë kur, dy muaj para përfundimit të luftës, iu ofrua paqja. Duke shpresuar edhe më tej se do të ngadhënjë, refuzon edhe vetë idenë se ndonjëherë do ta ndërprejë luftën, duke deklaruar se për këtë i ka ardhur Shpallja! Mirëpo, kur sheh se do të mundet t’i luhatet treva ndër këmbë, vetëm dy muaj pas kësaj deklarate, pranon ndërprerjen e zjarrit. Ndoshta i ka ardhur Shpallja e re.

Njësoj edhe Muhtar Thekafi, pas vrasjes së Huseinit në Kerbela, duke ndërmarrë kryengritjen shiite, ka paralajmëruar në saje të “shpalljes hyjnore” fitoren e shkëlqyeshme. Mirëpo, kur qe i thyer nga ana e Mus’ab Ibni Zubejrit, kumtoi se All-llahu “e ka ndërruar mendimin”.

Që nga atëherë shijnjtë lejojnë paqëndrueshmërinë e Vendimeve të Zotit dhe mundësinë që All-llahu t’i ndërojë ato.

Në shekullin XIX nga dogma e shiizmit rezulton feja e re e **Behainjve**. Sejjid Ali Muhammed Shirazi shpallet në vitin 1840 për “orator fuqiplotë” (Bab) i mamait të fshehur dymbëdhjetë, duke iu drejtuar ulemasë rafidinje dhe duke thirrur në mospërmbajtjen e ligjeve fetare, duke marrë parasysh fillimin e ciklit të ri të dërguarish, i dërguari i të cilit duhet të paraqitet. Shteti i dymbëdhjetëimaminjve në mënyrë të përgjakshme i qëroi hesapet (e këtë e bënë edhe në ditët tona)

KUSH JANË SHIJNJTË?

me këta shpikës të fesë së re, ndërsa Bab-in pas vdekjes së tij e zëvendëson Mirza-Husein Ali-Behaullahu, i cili shpallet për të dërguarin e paralajmëruar. Gjatë syrgjynimit në Stamboll, Behaullahu dërgon mesazhe sundimtarëve, të cilët i thirrë që t'i bashkohen. Djali i tij Abdul Beha' qe i mbyllur gjatë kohës së Abdul-Hamidit, e i liruar pas ardhjes së xhonturqve, prej kur filloi të ecën nëpër botë dhe të thërriste në "shpalljen" e re, e cila kishte ardhur për ta shprehur qenësinë e të gjitha shpalljeve të mëparshme. Englezët e emëruan kalorës për shkak të mësimit të tij për barazimin e të gjitha feve - "ngase çdo fe paraprake i hap rrugën fesë së re". Djali i tij Shukriu është prijatar i sotëm i behainjve. Vetën e quajnë anëtarë të Bashkësisë Botërore dhe besojnë se pas cecilit behaiu të vrarë, njëqind vetë tjerë pranojnë fenë e tyre. Sipas behaizmit, fuqia e vetme e Universit është fuqia e të Mirës. Shpirti duhet ta kalojë shkollën në trupin njerëzor duke mësuar dashurinë dhe vërtetëdashësinë. Parajsi është të jesh afër Zotit e skëterri të jesh larg Tij. Duke qenë se Zoti është i pakonceptueshëm, mënyra e vetmi që T'i robërojmë është që të jemi robër të personifikimeve të Tij - të Dërguarve, Imamëve, babëve. Meqë "shpallja" e themeluesve të tyre është përplotë gabimesh gjuhësore, behainjtë pohojnë se edhe të gjitha shpalljet e mëparshme, madje edhe Kur'ani (!) kanë gabime gjuhësore (andaj mohojnë mrekullinë gjuhësore të Kur'anit), dhe në ujdi me këtë është e mundur që të Dërguarit të gabojnë gjatë kumtimit të Shpalljes. Ata refuzojnë të lexojnë Kur'anin, ngase çdo fee re është më e përsosur nga ajo paraprake!!

Kështu arrijmë gjer në këtë shekull. Sunninjtë e humbasin shtetin e vet unik me ndërprerjen e kalifatit nga ana e Ataturkut

në vitin 1924. Ndërsa përkundruall rafidinjeve sjellen në mënyrë mjaft naive. Në vitet e dyzeta “Vëllezërit myslimanë” dhe Az’hari bëjnë përpjekje për bashkimin me rafidinjtë (!)

Përpjekja braktiset vetëm pas ardhjes së Homeinit në pushtet, kur natyra e vërtetë e rafidinjeve del sheshit tërësisht. Deri atëherë botohej revista “Risaletul-Islam (Porosia e Islamet), e cila propagonte bashkimin e sunninjve dhe shiinjve, e përsa i përket librave, është botuar vetëm tefsiri i Tabersiut “Mexhme’al-bejan”!

Revolucioni i Iranit në vitin 1979 përsëri zgjon shpresa sterile se këta janë shiinj të ri. Përsëri “Vëllezërit mysliman” dërgojnë një delegacion Homeinit, duke ofruar bashkëpunimin ë tyre në ndërtimin e një shteti të vërtetë islamik. Natyrisht, Homeini as që u denjua të përgjigjet.

FOTOGRAFI (faqe 119)

Në vend të kësaj fillon botimi i librave, të cilat e ngritnin fenë rafidinje. Menjëherë pas vitit 1981 botohet një vepër nga shkenca rafidinje mbi Hadithin e të Dërguarit të Zotit s.a.v.s.: “Vusulul ahjar ila usulil ahbar” (shkrimtar El-Amili (v. 984 h.), në të cilën shkrimtari thotë: “E tërë ajo që Ehli Sunneti thotë se është hadithi i saktë i të Dërguarit të Zotit, është i pasaktë”!! Ndërsa në traktatin e vet mbi kundërshtimin e domosdoshëm të Ehli Sunnetit, Homeini thotë: “Nga e tërë kjo është e dukshme se gjer tek ligjet arrihet duke iu përmbajtur Kur’anit dhe Sunnetit dhe duke i kundërshtuar mendimet e Ehli Sunnetit”

FOTOGRAFI (faqe 120)

Ngjarjet në Siri, ku Irani i përkrahte nusajrinjtë kundër sunninjve, dhe në jug të Libanit, ku shiinjët shfrytëzuan hyrjen e Izraelit për maskrime bënë që sunninjtë ta shohin realitetin.

Udhëheqësi sunnit në Iran Ahmed Mufti Zade, i cili pat organizuar pjesëmarrjen e sunninjve për ta rëzuar shahun, qe i burgosur menjëherë pas revolucionit pa kurrfarë asrsyeje, në mënyrë që të lirahet mu para vdekjes, pas torturimit të rëndë.

FOTOGRAFI (faqe 120) - Ahmed Mufti Zade pas lirim
nga tarturimet e burgut

Në fillim të vitit 1996 njëri nga personalitetet i vizitoi Emiratetet e Bashkuara gjatë muajit ramazan, ku mbloodhi të holla për ndërtimin e një xhamie sunnite në Iran. Gjat kthimit në aeroportin e Teheranit e pritë policia e fshehtë. Pas pesë ditësh trupi i tij u gjet në plehnishtë.

Duke iu drejtuar tubimit të të rinjve, Homeini thotë: “Fuqitë islame dhe joislame të botës nuk do të pranojnë shtetin tonë përderisa nuk e vendosim qeverinë tonë mbi Mekë dhe Medinë, pasi që ato janë qendra islame. Më së pari çka do të bëjë kur të hyjë në to, do të jetë t’i zhvarrosi dy idolët (Ebu Bekrin dhe Umerin) që janë të shtrirë afër Pejgamberit.”

Më në fund edhe “Vëllezërit Myslimanë” vijnë në vete. Njëri nga udhëheqësit e “Vëllezërve” sirianë, rahmetli Said Havva në veprën “Homeinizmi” flet me plotë hidhëti: “Pandehnim se shijnjtë pas fitores së Homeinit do ta braktisin shtirjen, mirëpo gjatë ndodhive vërejtëm së shtirjen e përdorin së bashku me pushkët e tyre. Njësoj - qoftë fjala për qeverinë në Siri apo për lëvizjen “Amel”, të gjithë ata fshehurazi bashkëpunojnë me Izraelin. Ndërmarrin luftë kundër sunninjve në çdo vend, e së këndejmi thërrasin për bashkimin e myslimanëve. Rinisë së udhëzuar myslimane i flasin të veshur me rroba të mashtrimit, duke fshehur natyrën e vet të vërtetë. Deri dje shtirjen e kanë përdor për t’u mbrojtur, kurse sot

KUSH JANË SHIJNJTË?

shërbehen me pushkë për të mbizotëruar, e me shtirje për t'i mashtruar të tjerët. Shikojni ata në Siri, në Turqi, në Pakistan, në Afganistan apo kudoqoftë tjetër, do t'i gjesht se si vishen në rroba të huaja për së jashtmi, deriuta nuk vijnë gjer tek ajo që kanë planifikuar. Kështu në disa shtete e bashkuan pushkën me shtirjen, ndërsa në disa të tjera ende janë vetëm në shtirje, me anë të së cilës hulumtojnë pushkën. Ka ardhur koha që rinia myslimane të kuptojë mashtrimin e tyre dhe t'i njoftojë në ecëncën e tyre. Ekziston vetëm një fe e drejtë, feja e Ehli Sunnetit, nga e cila rezulton çdo e mirë, kurse feja e atyre është e rrejshme dhe e falsifikuar, e nga ferrat nuk mund të mbiejë rrushi, e as nga gjembi fiku. Ai që gjykon mirë për homeinizmin, është zhytër në gabimin më të madh që mund të ekzistojë dhe mban mëkatën edhe në dunja edhe në ahiret, duke braktisur syqeltësinë e besimtarit, i cili nuk lejon të jetë i kafshuar dy herë nga zgavra e njëjtë. Disa, për të cilët supozonim se janë të vetëdijshëm, u treguan të pavetëdijshëm ndaj rrezikut nga homeinizmi; disa të tjerë, për të cilët supozonim se posedojnë dituri, ngecën në tërheqjen e vërejtjes nga homeinizmi dhe paksa nuk u zhduk ky ummet! Prandaj i thërrasim të vetëdijshmit që t'i hapin sytë e të diturit që t'i përdorin pendët dhe gjuhët. Ka ardhur koha të pengohet kjo murtajë që të përthapet në botën islame. Ka ardhur koha që sulmuesi të jetë i sulmuar. Detyrë e ummetit islam është që ta hap Iranin për fenë e pastër dhe ta ngadhënjejë rrezikun që është dendësuar mbi ummetin. Dhe, le ta dijnë ata, të cilët, me pendët dhe me gjuhët e tyre e lënë ummetin në lajthitje, se do të përgjigjen para All-llahut për përkrahjen e homeinizmit, ngase të përkrahësh homeinizmit do të thotë të trdhtosh

KUSH JANË SHIJNJTË?

All-llahun, të Dërguarin Tij dhe besimtarët. A nuk po e shihni se ç'bëri homeinizmi dhe aleatët e tij me fëmijtë islam kur u përforcuan? A nuk po e shihni aleancën e Iranit me secilin armik të Islamit?... E, ai i cili gjer më tani nuk është eselluar dhe nuk sheh qartë, atëherë çka do ta esellojë atë dhe çka do ta bëjë që të dëgjojë?... Këta homeininj janë armiq të miqve të All-llahut, prej as'habëve e më poshtë, e si lejon myslimani të jetë i mashtruar dhe si mund të mbështetet në ta? E, i Lartëmadhërishtmi thotë: ***“Dhe mos u mbështetni në ata që bëjnë zullum, e t’ju kapë zjarri edhe ju.”*** (Hud: 113)

A nuk shohin njerëzit se në Iran nuk ekziston asnjë ministër sunnit, edhe pse një e treta e popullatës është sunnite? A nuk shohin njeqëzit se çka bëhet me sunninjtë në Liban? A nuk shohin njerëzit se ç'bënë aleati iranian me Islamin dhe myslimanët? A nuk mjafton kjo për atë që i ka sytë në ballë? Vallë, pas të gjitha këtyre a ekziston arsyeja se jemi mashtruar? Me të vërtetë, të mashtruarit e kanë gjykuar vetveten e tyre me atë që janë bërë armiqë të këtij ummeti, të popujve të tyre dhe të atdheve të tyre, dhe të marrin pjesë në komplotin kundër ardhmërisë së ummetit, e, vallë, a do të pason teubeja? O All-llahu im! heqi dorë nga Homeini dhe nga homeinizmi dhe nga secili që i përkrah ata dhe bëhet aleat i tyre. Amin!”

FOTOGRAFI

(faqe 123) Rojter: *“Antagonizmi zyrtar iranian ndaj Izraelit, siç është raportuar shpeshherë, në realitet është maskë e lidhjeve diskrete.” - Mohtashemi, Abasadori i Iranit në Siri në vitin 1982: “Pas hyrjes së Izraelit në Libanon, nga Irani kanë arritur në Siri dy aeroplanë, por operacioni është*

KUSH JANË SHIJNJTË?

ndërprerë sipas urdhërit të Homeinit. Jam kthyer në Iran, duke u munduar ta bindë që të vazhdojë operacionin, por më kot.”

(faqe 124) - *Popullata sunnite e Iranit është tërhiqur në bjeshkë, në rajonet kufitare kah shtetet sunnite*

ÇKA NA PRET NEVE?

Irani, qysh para lufte, edhe në Bosnjë ka gjetur trevë të përshtatshme për zgjerimin e ndikimit të vet, duki i falënderuar mosekzistimit të dijetarëve. Literatura iraniane lirisht hynë në Bosnjë përmes automobilave diplomatik. Për qëllime propagandistike shfrytëzohet gatishmërie e Iranit që t'i dërgojë 10 mijë ushtarë në suaza të KB (duke e ditur mirë se KB kurrë nuk do të pranonte një gjë të tillë). Në numrin e gushtit të revistës “Bejan”, në vitin 1995, e cila del në Londër, vëllai ynë nga Senegali shkruan mbi përvojat e sunninjve me prapagandën e shiinjve në shtetin, në të cilin të gjithë janë sunninj. Duke qenë se te ne mbretëron një situatë e ngjashme, është për t'u pritur nga Irani që të përdor strategji të njëjtë. Së përi është filluar nga ana e abasadës iraniane me pritje (mysafirësh), me filma dhe me lajme. Pastaj janë ndërtuar qendra islame me diapazon të gjerë aktivitetesh, mes tjerash edhe edukativo-arsimore. Shërbimet mjekësore pa pagesë, salla leximi, përdorimi i tarikateve shiite, dhe më në fund, botimi i librave në gjuhën shtëpike, në të cilat sunninjtë shpjegojnë përse janë bërë shiinj, apo botohen dialogje në të cilat regullisht shiinj të mundin sunninjtë. Titujt e librave që i botojnë:

KUSH JANË SHIJNJTË?

“Summe ihtedejtu” (E pastaj u udhëzova);

“Li ekune mea sadikin” (Që të jem me të sinqertit);

“Mehdiu gjatë historisë, Muhammed Bakir Sadr;

“Përse e kam zgjedhur medhhebin e Ehli Bejtit”, El-Antaki;

“Vilaje”, Muhammed Bakir Sadr;

“Akide imamije” (Besimi i imamve), Muhammed Rida El-Muzaffer;

“Sekife” (Mbi zotimin Ebu Bekrit), Muhammed Rida El-Muzaffer;

“Pushteti Islam” (Tanimë e përkthyer), Homeini;

“Keshful esrar” (Zbulimi i fshehtësive), Homeini;

“Maalim el medresetejn”, Murted Askeri;

Pastaj vizita të shpeshta Iranit, shoqata miqësore iraniano-boshnjake, klube intelektualësh të tipit të mbyllur (ku hulumtohet për udhëheqës të ardhshëm). Allahu na ndihmoftë!

Dhe, derisa ky libër ishte në përgatitje e sipër për botim, më erdhi në dorë “Drita e të vërtetës”, që e ka botuar ambasada iraniane në Sarajevë, përkatësisht Qendra Kulturore e saj. Rafidinjtë kanë filluar me sulme frontale, dhe tani për tani depërtojnë pa kurrfarë rezistence.

Libri është botuar në suaza të bibliotekës “Bashkimi”, dhe për hir të bashkimit të myslimanëve i bie shuplakë çdo gjëje të shenjtë të sunninjve. Gjëja më e pikëllueshme është se përkthyesit janë boshnjakë, sikurse edhe lektori, përpunimi teknik...

Kush e di se a ka e lexuar këtë libër dikush prej atyre që do të duhej t’i kundërvihej kësaj përhapjeje të paturpshme të

KUSH JANË SHIINJTË?

fesë së huaj. A ekziston dikush nga qeveria boshnjake i cili është i interesuar që boshnjakët mos t'i kthehen shiizmit?

Irani as që tenton të përhapë fenë e vet në shtetet arabe apo në Pakistan, ngase aty ekziston ulemaja, e cila shumë lehtë do t'i qëronte hesapet me dredhitë e tyre. Por Afrika apo Bosnja, këtu rafidinjtë do t'i përqëndrojnë përpjekjet e veta.

Më 31 mars të vitit 1996 në Zenicë është mbajtur Sumpoziumi mbi Kur'anin Fisnik, në organizim të Qendrës Kulturore Iraniane dhe Rijasetit të Bashkësisë Izlame. Nga ana e shiinjve morën pjesë disa doktorë të shkencave kur'anore, të cilët shtinë nga të gjitha topat duke rrëzuar tërë atë që besojnë sunninjtë, dhe tërë këtë e bënë duke folur për nevojën e bashkimit.

Nga ana e boshnjakëve nuk mori pjesë kurrë ekspert i shkencave kur'anore, nga shkaku i thjeshtë se asnjë i tillë nuk ekziston në Bosnjë. Madje edhe ata profesorë të fakultetit islamik që ligjërojnë shkencat kur'anore, kanë specializuar gjuhën arabe, e jo shkencat kur'anore.

Në vend të kësaj, përfaqësuesit boshnjakë në Seminarë na folën për jomyslimanët në dritën e Kur'anit, për bashkimin e myslimanëve përmes Kur'anit, për shoqërinë islame në Kur'an, për fenë dhe politikën nga pikëpamja kur'anore dhe për seksualitetin në Kur'an! (opa!)

Edhe shehu dervish nga Kuçani pati rastin t'u tregojë doktorëve nga Irani se edhe ne kemi kalë për gara. Në shqyrtimin e vet gjenial, të cilin e titulloi "Analiza dhe analitika e universit të Zotit dhe fakultiteteve të tij", shehu ynë na mëson se si "nuk mund të ketë islamizim të besimit shkencor pa institucione të besimit shkencor, sheriatit,

KUSH JANË SHIJNTË?

tarikateve, ma'rifeteve, hakikateve dhe pa mësim universale, vahdetike, kur'anore, muhammedane, ndërsa bota e dukshme (paraqitëse) është të shpallurit analitik i univerzitetit të shpallur të All-llahut, i cili shpallet nga tri univerze, prej të cilëve çdonjëri shpallet me zzahirin dhe batinin e vet dhe me nga shtatë "mesane", që gjithsej bëjnë katërmëdhjetë realitete të shpallura paraqitëse dhe katërmëdhjetë realitete joparaqitëse, e $14 + 14$ bëjnë 28 realitete paraqitëse, kurse shpalljet universale të Absolutit të universitetit të shpallur të All-llahut përbëhen nga tri realitete fundamentale: subjektit universal të shpallur, kallëzuesit universal të shpallur dhe insanit universal, të Kur'anit universal dhe universitetit njerëzor universal, e Kur'ani Kerimi, si dhe universi iluminist i Zotit është i evidentuar dhe i shpallur në të gjitha katërmëdhjetë ($7 + 7 = 14$) kategoritë ekzistenciale (dy xhismani, aklani, ruhani, e nga një rahmani, subutijun, shuhudijun, zatijun, ajnijun dhe ilahijun), kurse shpallja e lashtë e Kur'anit është shpallur përmes 28 peygamberëve me 114 velijë dhe valijë, kalifë dhe naibë, e për sa i përket domethënies kur'anore, kjo është punë e velijve dhe valijve peygamberikë, karijve dhe arfëve, kurse vahdeti është në kesret, e "kesreti" është në "vahdet", e pa analiza dhe analitika, nuk ka konceptime as sintetika, kurse pa kategori të sheriatit, tarikateve, ma'rifeteve, hakikateve, vahdeti-subuteve, vahdeti-shuhudeve, vahdeti-zatijeve, ajnkut dhe ilahijeti-nefseve nuk ka analizë komplete dhe konceptim të Kur'anit Fisnik."

Ajo që alimi ynë i nderuar ka harruar të na thotë, është se një kilogram e tre çerek akrimoni kongenzistenciale shpall hipopleksinë peripatetike të megaprociteteve ekstraordiale.

KUSH JANË SHIJNTË?

Në fund na rekomandon që të hëzohemi, duke qenë vetëdijësimi dhe shpirtëzimi i myslimanëve është pashmangshmëri i këtij shekulli. O sa na freskoi me mendjehollësinë e vet shpallëse. Nuk din njeriu se a duhet qeshur apo qajtur.

Në kalim e sipër shehu ynë zë në gojë se “All-llahu është ekzistenti absolut, pa asgjë dhe pa askë së bashku me Të, ekzisteti fillikativetëm dhe njëivetëm” (mbi panteizmin tanimë kemi folur në këtë libër) i cili është mërëzitur të jetë Vetëm, andaj “që të mos mbetej i panjohur përveç Vetvetes, ngase çdo gjë që është e panjohur është e papranuar, e Krijoi një krijesë Universele në të cilin është Shpallur (bëhet Muhammed, shih kapitullin në këtë libër mbi mësimet panteistike të Homeinit). Pastaj ia vë në gojë All-llahut këto fjalë: “Unë kam qenë dhe jam përgjithmonë Fshehtësi e amshuar. Dëshira Ime personale ka qenë dhe është e amshuar, që pesonalisht të Shpallëm, andaj, për shkak të shpalljes Sime personale dhe egzistenciale, kam krijuar një krijesë të njohur universale me anë të të cilit Jam Shpallur.”

E pastaj kësaj krijese i ka thënë:

“O universi Im i shpalljes, sikur të mos ishe ti, Unë nuk do t’i Krijoja botët. Ty të kam krijuar për hir Timin, për hir të Shpalljes Sime personale, kurse botët dhe të gjitha krijesat e tjera i kam Krijuar për hir tëndin, përkatësisht, për hirë të shpalljes tënde personale, prandaj botët e shpalljes sate reale janë edhe analiza dhe shpallja yte.”

Dervish efendiu i bvukur, se sa bukur na qartësoi se All-llahu na Krijoi që të mos Jetë i panjohur. E, po valla, secili duhet ta marrë hakun e vet. Ndërsa shprehja të cilën shehu ynë

KUSH JANË SHIJNJTË?

ia përshkruan Krijuesit, i gjason shprehjes së Universiteti të Kroacisë gjatë kohës së Shpalljes.

Vërtetë, dervishi ynë në fund thotë se kjo do të mund të ishte ose Fjala e All-llahut ose fjalët e ndonjë arifi (zaten është njësoj!).

E edhe mysafirët tanë të nderuar nga Irani kishin të thënë diç:

- se mufessirët (komentuesit e Kur'anit) e gjertanishëm nuk kanë ditur për gjithëpërfshirjen kur'anore, derisa nuk erdhi Homeini

- se myslimanët duhet t'i pasojnë vetëm ato hadithe të të Dërguarit të Zotit, të cilat i transmetojnë pasardhësit e Aliut (e çka transmetojnë as'habët e tjerë, është e pasigurtë)

- se All-llahu gjendet në çdo vend (neudhubilah), dhe ata që cilët thonë (d.m.th. Ehli Sunnetët) se ajeti kur'anor **“Ai është me ju kudo që të jeni”** (El-Hadid: 4) don të thotë se Ai është i Informuar për çdo gjë që punojmë, janë të paaftë ta konceptojnë të vërtetën.

Mysafiri ynë i nderuar natyrisht nuk ka dashur ta lexojë ajetin e përmendur gjer në fund **“...All-llahu i sheh (të gjitha) çka punoni.”**

- se shpirti në fund do të jetë i “likuiduar” (të zhdukurit në Zotin).

- Që gjithë mysafirët me radh dëshironin ta vendosin në nivel të njëjtë besimin shiit se Kur'ani i sotëm është vetëm një e treta pjesë e “Kur'anit të vërtetë” (për çka kemi folur në këtë libër) dhe besimin sunnit se ka pasur ajete të zbritura të cilat nuk kanë hyrë në Kur'an, porse janë zëvendësuar me ajete të tjera, për çka flet edhe vet Kur'ani: **“Kur një ajet e**

zëvendësojmë me një ajet tjetër - e All-llama di më së miri se çka Shpall...” (En-Nahël: 101).

Prandaj thonë se ulemaja e Ehli Sunnetit “nuk kanë aftësi të të kuptuarit të brendshëm” Kurse për hadithet që flasin për ajete të këtilla - që nuk kanë hyrë në Kur’an - thonë se janë të trilluara, pa marrë parasysh se gjenden në koleksionet autentike të haditheve të Ehli Sunnetit, dhe kërkojnë që Ministria e Arsimit në shtetet myslimane të ndalojnë botimin e librave të këtilla!

Në të njëjtën kohë i mbrejnë ata, të cilët thonë se gjoja se vetëm Kur’ani i Aliut është Kur’ani i plotë, e që në realitet donë të thonë se ka të bëjë me komentarin e Kur’anit të Aliut. Gjatë kësaj tregojnë rrëfimin për të cilin kemi bërë fjalë në këtë libër, se gjoja se Aliu u ka ofruar as’habëve Kur’anin e vet të kompletuar, mirëpo këta kanë refuzuar.

Shiinjve nuk u pëlqen që Ebu Bekrit, Umerit dhe Uthmanit i përshkruhen meritat se janë kujdesur që fletët dhe pllakëzat në të cilat është shkruar Kur’ani gjatë kohës së Resulull-llahut s.a.v.s. të tubohen në një libër, dhe këtë e konsiderojnë si nxitës të dyshimeve në autenticitetin e Kur’anit.

- vërsulen në ulemanë e vjetër sunnite, e cila ka shkruar mbi rreziqet e shiizmit, siç për shembul Shehrestaniun, Ibni Haldunin dhe Ibni Tejmiun, dhe fjalët e tyre i quajnë “gënjeshtër të tmershme”.

Organizatorët e simpoziumit janë përkujdesur që ta sjellin njëfarë doktoreshe Aieshen nga Egjipti, e cila, sikurse edhe shumica e pjesëmarrësve boshnjak, është mbrojtëse për afrimin e sunninjve dhe shiinjve. Ajo pohon se “kurrnjë mysliman nuk dyshon në atë se shiinjte imaminjë (d.m.th.

KUSH JANË SHIJNTË?

dymbëdhjetëimaminjtë) nuk janë myslimanë. Si argument për këtë i citon fjalët e Kadi Abdul-Xhebbarit: “Konfirmimi mbi shtimin në Kur’an dhe mungimin nga ai, ka rjedhë nga pabesimtarët, të cilët janë fshehur pas medhhebit të “imaminje”.

Pra, Kadiu në mënyrë qartë thotë se imaminjtë janë ata pabesimtar të cilët i kanë fshehur qëllimet e veta me pretekst se po e pasojnë “Imamin” nga pasardhësit e Aliut. Ndërkaq, Aisha jonë është përpjekur që këtë deklaratë të Kadiut ta kuptojë në mënyrën e vetë, përkatësisht se në mesin e imaminjeve, të cilët sipas mendimit të saj janë myslimanë”, ka pasur pabesimtarë të cilët janë shtirë kinse se janë imaminj.

Ulemaja islame e konsideron ulemanë shiite kafir (pabesimtar), ngase me vetëdije kanë devijuar nga feja burimore, ndërsa njerëzit e thjeshtë të tyre për xhahilë (injorantë), të cilët duhet të thirren në fenë e vërtetë, e nëse refuzojnë, atëherë edhe për ata mund të thuhet njësoj sikur edhe për ulemanë e tyre.

Shejhul-Islam Ibni Tejmiu thitë:

“Është e lejuar të mbytet cilido prej tyre nëse është thirrës në fenë e tij apo në ndonjë mënyrë paraqet rrezik, siç ka dashur Ali b. Ebi Talibi ta mbyt Abdullah Ibni Seba’n, rafidiun e parë, i cili ka ikur larg tij. Dhe për arsye se janë ngatërrestarë më të mëdhenj në Tokë, andaj nëse ngatërresat e tyre nuk mund të ndalen në ndonjë mënyrë tjetër po me vrtasje, atëherë duhet të vbriten.

Nuk duhet mbytur çdo individ prej tyre nëse nuk shfaq haptazi fenë e vet, ose nëse vrasja e tij do të sjell më tepër dëm sesa dobi.

Përsa i përket proklamimit të tyre jobesimtarë dhe qëndrimin e tyre të përhershëm në zjarr, çdonjëri prej tyre veç e veç bëhet jobesimtar nëse thotë diç për çka e din se është në kundërshtim me atë që ka thënë i Dërguari i Zotit, e përsa i përket veprave të tyre, atë bëhen jobesimtarë nëse veprojnë kundër myslimanëve siç veprojnë jobesimtarët.”

Tani t'i kthehemi “Dritës të së vërtetës”. Nga ky libër mund të parandihet se me çfarë metodash do të shërbehen rafidinjtë në Bosnjë. Kujdesi kryesor i është dhënë sulmit të koleksioneve sunnite të fjalëve dhe veprave të Resulull-llahut s.a.v.s., ngase Resulull-llahu s.a.v.s. ka qenë ai që ka folur dhe ka vepruar ndryshe nga ajo që dëshirojnë rafidinjtë.

Kujdesi i dytë është drejtuar që të diskreditohen (përçmohen) tre kalifët e parë dhe shokët e tjerë të të Dërguarit të Zotit, dhe bashkëshorteve fisnike të tij. Mirëpo, asnjëri nga këto sulme nuk realizohet në mënyrë të haptë, porse kjo bëhet kalimthi në suazat e ndonjë tematike tjetër, madje shpeshherë edhe në fusnota, kështu që lexuesi i pakujdesshëm as do ta vërejë këtë, ndërsa qëllimi do të jetë i arritur, e ky është që gradualisht të mbillet dyshimi në tërë traditën sunnite.

Edhe ky libër për të cilin është fjala, më së tepërmi helm mbjell mu në fusnota. Libri sa për dukje flet për Kur'anin, duke i përsëritur të njëjtat tema të cilat i kemi përmendur mbi seminarin në Zenicë. Synimi i librit, siç dëshirohet të paraqitet, është afrimi i sunnizmit dhe shiizmit, mirëpo synimi i vërtetë është mbjellja e virusit të dyshimit në atë që shekuj me radhë kemi besuar në Bosnjë.

Në fillim të librit autorët theksojnë se janë të mburrur që i takojnë medhhebit (tanimë kemi përmendur se rafidinjtë

dëshirojnë të tregohen si një nga shkollat juridike të fikhut) “qëllimi i të cilit është ta shpëtojë Kur’anin që të mos varroset” (Për dallim nga medhhebet e tjera, d.m.th. të sunninjve).

Pastaj na rrëfejnë se si Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë për Aliun: “se sheh dhe dëgjon atë që edhe vet sheh, vetëm që ai nuk është peygamber”, ndërsa Aliut i përshkruajnë se ka thënë që, derisa ishte fëmijë “peygamberi e vinte atë në shtratin e vet dhe e mbështeste kraharorin e vet në të tij, e afronte trupin e vet afër të tij” (pederllëku është tejte i përhapur ndër shiinjtë). Si argument për këto dokrra parashtrojnë librin, të cilin e kemi përmendur më herët, “Nexhdul-belaga”, të cilin e kanë shkruar shiinjtë duke ia përshkruar Aliut, e Bashkësia Islame e Zagrebit nuk ka prituar që ta përkthejë dhe ta botojë! Të paramendojmë vetëm lexuesin e padijshëm, i cili do ta lexojë këtë helm, e në fund të tekstit të shohë: “Botim i Bashkësisë Islame - Zagreb”

Lexuesit të tillë kjo i mjafton që ta marrë si autentike krejt atë që ka lexuar këtu. Rafidinjtë e dinë mirë këtë, andaj pas çdo citimi nga ky libër, doemos shtojnë: “Botim i Bashkësisë Islame - Zagreb”, dhe atë mu në mes të faqes, e jo në fusnot siç është e zakonshme.

O Bashkësi Islame në Zagreb, a jeni të vetëdijshëm se do ta bartni përgjegjësinë për secilin boshnjak i cili do të shiizohet, mes tjerash duke falëderuar edhe kontrubutit Tuaj?

Pastaj autorët na rrëfejnë se si, me rastin e ardhjes së Xhibrilit në Medinë “atë e pritnin vajzat më të bukura”?!? (Shiinjtë e kanë shumë merak të theksojnë se Islami nuk është kundër asaj që të përzihen mashkujt dhe femrat. baluçistanasit sunninj më kanë rrëfyer se si qeveria iraniane përpiqet që në

KUSH JANË SHIINJTË?

çdo mënyrë t'ua prishë moralin baluçistanasve, në mënyrë që më lehtë t'i mbajë nën ndëgjese).

Kështu rafidinjtë në mënyrë të pandjeshme tentojnë ta nxijnë fotografinë që kanë myslimanët mby sahabinjet, të cilat ja këtu nuk kanë tjetër punë, pos të dalin para mashkujve të vrullshëm.

Resulull-llahu s.a.v.s. që në fillim të Shpalljes natyrisht ka qenë i frikësuar nga zëri i Xhibrilit, i cili e ka thirrë që të përsëris pas tij ajetet e para të Kur'anit, e kur pas kthimit nga shpella Hire e ka para Xhibrilit në formën e tij të vërtetë me njëqind krihë, ka menduar se ka të bëjë me xhinn dhe i frikësuar shpejtoj për në shtëpi dhe u mbulua, andaj edhe vet Kur'ani e fton: ***“O ti i mbuluar! Ngrihu dhe tërhiq vërejtjen (duke i thirrur)”***. (El-Muddeththir, 1-2).

Shiinjve nuk u pëlqen diç këtu, andaj thonë: “nuk është e vërtetë ajo që është parashtruar në Buhariun dhe Muslimin, se i Dërguari i Zotit ka dëgjuar zërin në shpellë duke e thirrur...” “Është tejet e qartë se këtë rrëfim, të cilin e sjellin Buhariu dhe Muslimi, e kanë treguar mendjet laike primitive”.

Natyrisht, qëllimi i tyre dhelpërak është që ta diskreditojnë Buhariun dhe Muslimin, dy koleksionet sunnite më autentike të haditheve të Resulull-llahut s.a.v.s. e tërë e këtë si në të përkimt, duke folur për llojet e Shpalljes.

Pas çdo kapitulli, autorët bëjnë pyetje, siç veprojnë edhe këtu:

“A është i vërtetë rrëfimi që sjell Buhariu, dhe përse?”

Është e qartë se këtë libër dëshirojnë ta bëjnë vepër të programit arsimor. Ku jeni zotëri të Bashkësisë Islame, Rijasetit, Ministrisë Arsimore...??

Ulemaja e Ehli Sunnetit na mëson, në bazë të deklaratave autentike të Resulull-llahut s.a.v.s., se si Kur’ani së pari ka zbritur në Lehvi Mahvudh në qiellin e Tokës në tërësi, natën e Lejletul-kadrit: **“Vërtet ne e shpallëm atë (Kur’anin) natën e Kadrit”**. (El-Kadër: 1), e, pastaj nga qielli i Tokës suksesivisht i ka zbritur Resulull-llahut s.a.v.s. nëpërmes Xhibrilit: **(TEKSTI ARAB, f. 135) “Dhe, Ne, Kur’anin e kemi shpallur pjesë-pjesë, që ti t’jua mësosh njerëzve dalngadalë, dhe Ne atë e zbritëm me lëshim”**. (El-Isra: 106)

Jy ajet kur’anor flet për dy lloje të zbritjes së Kur’anit. Pjesa e parë e ajetit për zbritjen suksesive të Kur’anit nga qielli i Tokës deri te Resulull-llahu s.a.v.s. nëpërmes të Xhibrilit, ndërsa pjesa e dytë e ajetit flet për zbritjen e parë të Kur’anit, të tërin përnjëherë nga Lehvi Mahfudhi në qiellin e Tokës.

Ibni Abbasi transmeton nga i Dërguari i All-llahut:

(TEKSTI ARAB, f. 136)

“Kur,ani ka zbritur natën e Kadrit në muajin Ramazan në qiellin e Tokës i tëri pëqrnjëherë, e pastaj ka zbritur gradualisht.” (Shënon Et-Taberani).

Përsa i përket zbritjes së Shpalljes nëpërmes të Xhibrilit, Kur’ani thotë kështu:

(TEKSTI ARAB F. 136)

“Dhe me të vërtetë, ai (Kur’ani), është Shpallja e Zotit të Gjithësisë. Atë e e ka sjellë Shpirti i besueshëm (Xhibrili) në zemrën tënde, që të bëhesh nga ata që paralajmërojnë.” (Esh-Shu’ara’: 192-194).

Ndërkaq shijnjtë, për shkak të mësimeve të veta të krishtere mbi Njeriun e Përkryer Muhammedin, të rezultuar nga vetë shkëlqimi i All-llahut (me anë të “emanacionit”) (mu

KUSH JANË SHIJNJTË?

sikurse Isai a.s. te të krishterët), për çka kemi bërë fjalë më herët, i mohojnë këto ajete dhe hadithe të qarta dhe pohojnë se Kur'ani i është shpallur të Dërguarit të Zotit i tëri përnjëherë qysh më herët, andaj paraprakisht e ka ditur se çka do t'i shpallet.

Por, sikur ta dinte Resulull-llahu s.a.v.s. paraprakisht se çka do t'i shpallet, atëherë nuk do t'i lejonte vetes të jetë i qortuar: ***“Ai (Muhammedi) u mrrol e u kthye (me fytyrë), ngase i erdhi pranë i verbëri.”*** (Abese: 1-2), kur qe kthyer nga i verbëri, i cili interesohej për Islam, ngase ishte i zënë me parinë kurejshite; nuk do të priste një muaj të tërë të zbresë ajeti i cili e mbron nderin e bashkëshortes së tij të ndershme Aishes nga shpifjet, atëher kur atë e kishte zënë gjumi e karavani kishte vazhduar rrugën duke mos ditur se Aisha nuk është në shkalcin e saj: ***“Me të vërtetë, ata që bënë shpifje (ndaj bashkëshortes së Muhammedit), janë një grup prej jush. Mos e konsideroni këtë (shpifje), të keqe për ju. Jo, kjo është mirë për ju. Çdonjëri prej tyre, do të dënohet për atë që ka bërë, e atë, prej tyre që ka bërë më së shumti, e pret dënimi i madh.”*** (En-Nur: 11).

Mendjeprehtësia e Umer Ibnul-Hattabit është e njohur mirë te myslimanët, e cila veçanërisht është shprehur gjatë kalifatit të tij kur qe e nënshtuar edhe Persia. Disa herë ka ndodhur që të zbres ndonjë ajet kur'anor duke vërtetuar mendimin e Umerit.

Kështu transmeton Buhariu se kur vdiq prijësi i munafikëve Abdullah b. Ubejj b. Seluli, djali i tij, Abdullahu erdhi te Pejgamberi s.a.v.s. dhe kërkoi që t'ia falë xhenazen. Umeri r. a. kërkoi që të mos e bëjë këtë. Duke mos dëshiruar

t'ia refuzojë lutjen djalit të Abdullahut, të cilin e kishte as'hab të dashur, për dallim nga babai i tij, Resulull-llahu s.a.v.s. mexhithatë i paraprinë namazit të xhenazës, pas çkafit zbret ajeti Kur'anor: ***“Dhe asnjërit prej tyre kur të vdesin, mos ia fal namazin (e xhenazes), e as mos qëndro pranë varrit të tij.”*** (Et-Teube: 84).

Kjo Shiinjve, të pezmatuar në Umerin për shkak të Persisë, asesi nuk u pëlqen, andaj autorët e librit për të cilin jemi duke folur, mohojnë ngjarjen edhe pse këtë e transmeton Buhariu, duke shtuar:

“Është fatkeqësi e madhe që, shumë nga këto ngjarje janë të trilluara dhe të falsifikuara, e gjenden në koleksionet e mëdha të haditheve të Buhariut, të Muslimit e të tjerëve, në të cilat mbështetet Ehli Sunneti”.

Pastaj thonë: “Është për t'u çuditur në këtë rrëfim, të cilin e transmeton Buhariu se Umeri e ka ditur që falja exhenazes munafikut është e ndaluar para se të shpallet ajeti për ndalimin e saj. Vallë, a është e mundur që Umeri të jetë i frymëzuar me atë që Pejgamberi nuk e di dhe të jetë dërguas i sheriatit Pejgamberit?”

Kjo është mënyra çfarë përdorin rafidinjtë që t'i mashtrojnë të paarsimuarit. Askush nuk thotë se Umeri ka ditur diç që ende nuk është shpallur. Umeri thjeshtë ka kosideruar se nuk është e denjë që Pejgamberi ta përcjellë xhenazen e udhëheqësit të munafikëve.

Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: **(TEKSTI ARAB, F. 138)**

Te ummeti para jush, ka pasur njerëz të frymëzuar, e nëse të tillë ekzistojnë në ummetin tim, atëherë ky është Umeri.” (Buhariu, 5/7/38).

Ebu Talibi, babi i Aliut dhe xhaxhai i Resulull-llahut s.a.v.s., ka vdekur si jobesimtar, duk mos dashur të pranojë Muhammedin për Pejgamber. Buhariu transmeton (6/87/119) se Resulull-llahu s.a.v.s. ka kërkuar falje për Ebu Talibin, përderisa nuk u shpall: ***“Nuk është për Pejgamberin dhe besimtarët, që të kërkojnë falje për idhujtarët, madje, qofshin edhe të afërm të tyre, pasi që t’ju bëhet e qartë se ata janë banorë të Xhehennemit.”*** (Et-Teube: 113).

Kjo nuk u pëlqen autorëve të librit në fjalë, andaj thonë se hadithi është i falsifikuar dhe i trilluar edhe pse e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, dhe shtojnë: “Për mosbesimin e tij mund të flasin vetëm shpirtligët dhe armiqët e Islamit dhe të myslimanëve, primitivët dhe shpifësit.”

Pastaj autorët lëshojnë një helm të vetin vdekjeprurës nga fusnota. Kësaj radhe sakrificë është njëri nga mufessirët më të mëdhenj sunnitë Ibni Kethiri, i cili ka shkruar mund të madh që t’i përmbledhë hadithet, të cilat i komentojnë ajetet kur’anore. Ja se si flasin autoirët për të, me shkronja të imëta nën tekst: “Disa prej tyre i ka kapluar shejtani dhe kanë harruar Vërejtjen e All-llahut. Për shkak kokëforcisë së vet i kanë fshehur faktet për përparësinë e Ehli Bejtit. (Kur shiinjte përmendin Ehli Bejtin, ata kanë parasyshë vetëm Aliun dhe pasardhësit e Fatimes. Ky nocion, i cili shënon familjen e Resulull-llahut s.a.v.s., natyrisht ka kuptim më të gjerë, dhe përfshinë edhe bashkëshortet e Resulull-llahut s.a.v.s. si dhe pasardhësit e xhaxhait të tij Ebu Talibit, Abbasin dhe Akilin). Ndër ta është edhe Ibni Kethiri në tefsirin e vet. ***“Ata përpiqen që me gojën e tyre ta shuajnë dritën e All-llahut, e All-llahu nuk do tjetër, pos ta përsosë Dritën e Tij.”*** (Et-Tevbe: 31)

Ja kështu rafidinjtë i lejojnë vetes ngandonjëherë të shpërthejë urrejtja e fshehur e tyre dhe ta zbulojnë fytyrën e vërtetë që kanë. Parimi i tyre i shtirjes aty-këtu dështon, dhe e vuan mufessirin tonë më të madh nën ajetin i cili flet për jobesimtarët që dëshirojnë ta shuajnë Dritën e All-llahut! Pyetja është se a kanë boshnjakët mjaftë maska kundërgaz.

Pastaj arrijmë gjer te çështja e zbritjes së Kur'anit në "shtatë harfe", siç flet për këtë hadithi i Resulull-llahut s.a.v.s. të cilin e transmeton Muslimi (1357)

TEKSTI ARAB, faqe 139

"Kur Resulull-llahu s.a.v.s. ishte te fisi Gifar, i erdhi Xhibrili e i tha: "All-llahu të urdhëron që t'ia mësosh Kur'anin ummetit tënd sipas një dialekt!", e Resulull-llahu s.a.v.s. tha: *"Kërkoj falje nga All-llahu, me të vërtetë ummeti im nuk do të mund ta durojë këtë."* Pastaj i erdhi për të dytën herë e i tha: "All-llahu të urdhëron që t'ia mësosh Kur'anin ummetit tënd sipas dy dialekteve!", e Resulull-llahu s.a.v.s. i tha: *"Kërkoj falje nga All-llahu, me të vërtetë ummeti im nuk do të mund ta durojë këtë."* Dhe nuk ndërpreu përsëritjen gjersa Xhibrili nuk i tah: "All-llahu të urdhëron që t'ia mësosh Kur'anin ummetit tënd sipas shtatë dialekteve, sipas cilitdo që të mësojnë është e drejtë!"

Hadithet të cilat flasin për zbritjen e Kur'anit në shtatë harfe janë të shumta dhe të njohura, dhe është plotësisht e qartë se ka të bëjë me shtatë dialekte të ndryshme të gjuhës arabe, në mënyrë që të gjithë ta kenë lehtë ta kuptojnë Kur'anin e zbritur.

Shiinjve kjo nuk u pëlqen, dhe do të dëshironin që këto shtatë harfe t'i komentojnë në mënyrën e tyre batinije, përkatësisht që secili ajet kur'anor ka më shumë domethënie të

KUSH JANË SHIJNTË?

ndryshme, e në këtë mënyrë do të mundnin ta komentojnë Kur'anin si t'u pëlqejë atyre.

Përsa i përket mësimit sunnit përekitazi me shtatë harfet, atë e quajnë “gënjeshërë në All-llahun”, siç është edhe hadithi, të cilin e transmeton Muslimi, e të cilin e parashtroam, “gënjeshërë e rëndomtë në të Dërguarin e Zotit”

Sulmet në Buhariun dhe në Muslimin i përsërisin përsëri në këto faqe. Qëllimi u është i qartë: të goditen koleksionet sunnite të haditheve, të goditen komentatorët sunnitë të Kur'anit, të goditen as'habët, të goditet akideja sunnite.

Pastaj zotërinjtë i përsërisin tregimet e njëjta e të vjetra të tyre për Kur'anin e Aliut, saqë edhe tubimin e faqeve të Kur'anit në një libër, që ka qenë vepër e tre kalifëve të parë, ia përqreshkruajnë Aliut të ndjerë.

Dhe pastaj, nën titullin e padjallëzuar “Bashkimi i Kur'anit”, përsëri një fusnotë e helmuar. Kësaj radhe është shënuar Uthmani, e sahabiu Ibni Mesudi kinse paskësh thënë se Uthmani është duke i ndërruar dispozitat e All-llahut dhe se mbi të është derdhur pezmi i Zotit!!!

Ne na mbetet që me të drejtë të pyetemi - **kush ka qenë recensent i këtij libri; kush ka lejuar që të botohet e të shpërndahet?**

A do të na kishte lejuar Irani që në mes të Teheranit të botojmë libra, në të cilat shahet Homeini?

Dhe jo vetëm kaq, porse paturpësisht e akuzojnë Uthmanin se ka urdhëruar që Ibni Mesudin e përmendur ta përzënë nga xhamia, saqë ia patën thyer edhe brinjët nga goditjet e shumta! Pastaj kishte vajtur tek Aliu, i cili ishte përkujdesur për të!!! Madje Uthmani i kishte thënë Aliut që ta mbyllë gojën!!!

Si burim të budallallëku marrin Jakubiun, historianin shiit. Gjëja më e rrezikshme është se shumë emra të njohur të historianëve të Islamit janë shiinj, siç janë Jakubi, Me'sudi apo Isfahani, autor i librit "Agani", në të cilën i përshkruan kalifët sunnitë si shfrytëzuas të alkoolit dhe të grave, gjë që orientalistët do ta bartin në librat e tyre të historisë islame.

Në këtë kaptinë janë përpjekur që të fusin dyshimin edhe në Kur'anin që e kemi sot në dorë, me pretekst se në musafet, që ka urdhëruar Uthmani të tubohen dhe të dërgohen në viset e ndryshme të shtetit islam, "janë bërë shumë gabime dhe lëshime si ato gjuhësore ashtu edhe stilistike, e të gjitha këto eksemplarë janë humbur." Ne u rekomandojmë atyre të vizitojnë muzeun Topkapi, apo në Kairo, apo në Petrograd, ku do të mund t'i shohin ato.

E pastaj, mu në mes të kaptinës e cila flet për tubimin e Kur'anit në shekullin e parë hixhrij, tema nga ky shekull. Armiku gjakësor dhe fqiu i Iranit ia trazon planet - Arabia Saudite! Por si të ndërlihet kjo në kaptinë?

Ja se si: "Ne shohim disa sundimtarë në shtetet islame të cilët nuk kujdesen për kurgjë tjetër pos për madhështin e tyre dhe për sundimin e tyre mbi myslimanët, e nga anja tjetër aspak nuk kujdesen për interesat dhe të mirat e myslimanëve. Aq më tepër, ata i nxisin dhe i ndihmojnë interesave të armiqëve të Kur'anit kundër interesave të myslimanëve dhe këtë e bëjnë shimë lehtë. Mirëpo, përkundër kësaj haptazi deklarohen si besimtarë dhe botojnë Kur'ane e i shpërndajnë ato nëpër botë. Me këtë, këta munafikë, sundimtarë dyfityrësh, haptazi tregojnë lidhshmërinë e tyre me namazin, zekatin, haxhxin, agjërimin dhe me ibadete të tjera publike fetare.

Ndërkaq, kjo praqitje e tyre publike nuk është asgjë tjetër pos mashtrim i myslimanëve.”

Në fund edhe e mallkojnë as’habin Muaviun, kalifin e pestë, dhe djaln e tij Jezidin, të cilin e quajnë “pirash” (“pijanec”). Megjithatë nuk besoj se në vende të tjera të Ehli Sunnetit do të kishin guxim të botojnë diç të këtillë. Me siguri mendojnë se këtu në Bosnjë askush nuk do të guxojë t’u kundërvihet atyre. E kush e ka ndihmuar më së shumti popullin boshnjak gjatë luftës dhe pas luftës, është parë dhe do të shihet.

Ja, përsëri gjendemi tek një titull i padjallëzuar nën të cilin përgjon gjarpëri: “Pandryshueshmëria e Kur’anit”, e pastaj:

“Kur i është afruar vdekja të Dërguarit të Zotit, e i dërguari i Zotit pat thënë: *“Hajde t’ua shkruaj testamentit, pas të cilit nuk do të bredhni”*, Umeri pat thënë: “I dërguari është i sëmurë (në një rivajet tjetër: I Dërguari flet përçarë). Ju mjafton Kur’ani...”

T’i kthehemi Buhariut, e të shohim se ç’thotë Umeri për Resulull-llahun s.a.v.s. se ai “flet përçarë”, e këtu del se:

TEKSTI ARAB F. 143

“...E Umeri tha: “Iu zmadhuan dhëmbjet të Dërguarit të All-llahut, s.a.v.s., ju e keni Kur’anin, ne na mjafton Libri i All-llahut...” Të përçarët as që përmendet. Umeri vetëm dëshiron ta mbron të Dërguarin nga mundimet, ngase e shihte se është duke vuajtur. E si atëherë ia përshkruan Umerit këtë që thonë për të? Autorët thonë: “në rivajetin tjetër”. Të shohim këtë rivajet tjetër:

TEKSTI ARAB, F. 144

KUSH JANË SHIJTË?

“...E thanë (as’habët (e pranishëm): “I dërguari është në jermi (nga sëmuda)...” (El-Buhariu, në kaptinën mbi Xhihadin dhe jetëshkrimin e të Dërguarit të All-llahut, nr 2825)

Jeni duke bërë dredhira zotërinj rafidinj, a mos mendoni vallë, se askush tjetër nuk di të kërkojë “rivajet tjetër”? Ndërsa në pyetjen pas pas përfundimit së kaptinës, janë munduar t’i pyesin fëmijët e mektebit, të cilët do të duhej të mësonin mbi Kur’anin dhe Islamin nga ky libër i tyre: “A është e lejuar të thuhet për të Dërguarin e Zotit se ai flet përçar?”

Atë që kanë ndërmend të arrijnë me këtë hadith, është se do të donin të argumentonin se Resulull-llahu s.a.v.s. ka dashur të testamentojë trashëgimin e Aliut pas vdekjes së tij, porse Umeri e ka penguar në këtë. Mirëpo, mu ky hadith sqaron se Resulull-llahu s.a.v.s. para vdekjes (në të njëjtën ditë) i ka porositur gojarisht rtri gjëra, porse këtë pjesë të hadithit autorët nuk kanë dashur ta përkthjenë, ngase në këto porosi as që përmendet trashëgimi nga ana e Aliut. Këto tri porosi janë: që të krishterët dhe hebrenjtë të përzihen nga Gadishulli Arabik, që të vazhdohet me dhënien e dhuratave delegacioneve që vijnë ta pranojnë Islamin, ndërsa porosinë e tretë transmetuesi i hadithit këtu e ka harruar, por në koleksionet e tjera të haditheve gjejmë se kjo porosi e tretë është të përmbajturit e fuqishëm Kur’anit.

Në kaptinën vijuese në radhë janë Umeri dhe Uthmani, të cilët “fshijnë” dhe “shtojnë duke shkruar” në Kur’an ashtu si u pëlqen atyre, ndërsa Umeri “i është kundërvënë Resulull-llahut s.a.v.s. dhe veten e ka konsideruar si mik të Muhammedit, dhe në mënyrë arbitrare i ka anuluar dispozitat fetare siç është martesa e përkohshme.”

Ja këtu jemi pra, ruajuni o ju boshnjake!!!

E, përse i përket “konsiderimit” të Umerit për as’hab të Resulull-llahut s.a.v.s. , le të na thotë vetë Resulull-llahu s.a.v.s.:

TEKSTI ARAB, F. 145

“O djali i Hattabit, pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, kurdoherë që të sheh shejtani duke ecur nëpër rrugë, ai merr rrugë tjetër.” (El-Buhari, 3383)

Pastaj arrijmë gjer tek tema tanimë e përmendur, mbi zëvendësim e disa ajeteve të zbritura me ajete tjera, që do ta shfytëzojnë për t’u vërsulur në shkencën e hadithit sunnit:

“Është shumë e çuditshme që ekzistojnë disa njerëz, të cilët konsiderojnë se librat që përmbajnë kësi lloj traditash janë libra më autentike hadithesh, ndërsa të gjitha traditat dhe hadithet në to i konsiderojnë autentike.”

Si ju duket, ju disa njerëz, a do t’u lejojmë edhe më rafidinjtë të na shajnë shnjtëritë tanë, apo ndoshta është më mirë t’i pranojmë përrallat e tyre, e të fillojmë me persekutimin e atyre që nuk dëshirojnë ta braktisin Buhariun dhe Muslimin e të pranojnë Homeinin?

Në fund të librit, një pjesë e tekstit flet për akidenë - besimin. Së pari në mënyrë naive na informojnë se si i Dërguari i Zotit e ka nderuar bashkëshorten e vet Hatixhenb (pra jo edhe Aishen, vajzën e Ebu Bekrit, as Hafsen, vajzën e Umerit), se si e ka dashur vajzën e vet Fatimen (pra jo edhe vajzat e tjera të tij, të cilat njëra pas tjetrës kanë qenë bashkëshorte të Uthmanit).

Pastaj do të dëshironin të na mësonin se është e lejuar të kërkohet ndërmjetësim gjer tek All-llahu me anë të tyrbeve, e

si argument marrin ajetin kur'anor: ***“Kush mund të angazhohet për ndokend pa lejen e Tij?”*** (El-Bekare: 25), i cili flet për shefa'atin e ahiretit (ndëqrmjetësim tek All-llahu), atëherë kur Resulull-llahu s.a.v.s. do të bënë shefa'at tek All-llahu për mëkatarët e rëndë nga ummeti i vet, shehidët për shtatëdhjetë anëtarë të familjes së tyre, fëmijët për prindërit e tyre dhe prindërit për fëmijët e tyre, etj.

Së fundi do të dëshironin të na argumentonin se nuk do ta shohim All-llahu në ahiret, duke dëshmuar këtë me përgjigjen Musait a.s.: ***“...Nuk mund të më shohësh...”*** (El A'raf: 144)

Atë që transmetojnë Buahriu dhe Muslimi mbi pamjen e Sunduesit në ahiret siç e shohim hënën e plotë në natën pa re, i quajnë hadithe “të falsifikuara nga ana e injorantëve, të cilët nuk e kuptojnë Islamin”.

Edhe për fund kanë lënë ngandonjë “margaritar”. Më së pari All-llahu ka dërguar një guri nga qielli qa ta mbys njafar Harithi, i cili kishta dashur të pranojë të tërë Islamin pos asaj se Aliu është trashëgues i të Dërguarit të Zotit. Ndoshta për këtë shkak serbët kanë gjuajtur nga kodra, ngase nuk jemi shiinj!

Kurse në fusnotën e fundit, në faqen e fundit të librit, nëse nuk e keni ditur, kalifi i pestë Muaviu urdhëron që të mbytetet secili që e don Aliun!!!

Ja pra, në këtë mënyrë “vëllezërit” tanë nga Irani, që na mësojnë Kur'anin nëpër xhamia gjatë Ramazanit, përhapin vëllazërimin dhe bashkimin e myslimanëve prej qendrave Kulturore të tyre nëpër botë. Ja kështu arritën edhe tek ne...

Që të shporren ashtu si kanë ardhur InshaAll-llah!

Dhe tju them edhe këtë, se si do të reagojnë rafidinjtë në këtë libër. Do të përpiqen njësoj që autorin ta likuidojnë. Kjo

KUSH JANË SHIJNJTË?

është metodë e tyre. Cok i falënderojë, ngase çdonjëri prej nesh ka dëshirë të jetë shëhid. Ndërsa për librin do të thonë kështu:

“Dallime sektare, të cilat kryesisht i përhapin dhe i intensivojnë shkrimtarët mercenarë dhe njerëzit qëllimkëqinj...” Kështu u është drejtuar udhëheqësi fetar i Iranit Homeini në mesazhin me shkrim drejtuar haxhilerëve të botës në këtë vit.

Kështu ti neve o prijës i Iranit, “shkrimtarë mercenarë dhe njerëz qëllimkëqinj”. Nuk e di se a mos vallë mendon në rajën tënde nga qendra kulturore iraniane, të cilët, jo vetëm që përhapin dallimet sektare, por edhe haptazi na thërrasin që ta braktisim fenë tonë e të pranojmë të tyrën, e cila është e bazuar në gënjeshtër e falsifikime dhe në fshehjen e së vërtetës, apo mendon në ne, të cilët ua tërheqim vërejtjen popullit boshnjak për dredhitë tuaja?

Dhe falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botëve!

Muharrem, 1417/qershor 1996

LITERATURA MBI SHIJZMIN

Më e vjetra:

Arabisht

Më e reja:

Arabisht

24. Majlisul ulema of south Afrika: "The Truth about Shiism"

25. H. Corbin: "Histoire de la philosophie islamique"

26. M. Sharif: "A History of Muslim Philosophi"

27. H. Laoust: "Les Schismes dans L'Islam"

28 Sami Makarem: "The Druze Faith"

29. "The Jezids"

30. "Materials for study of the Babi religion"

31. A. Heyly: "Autobiography of Malcom X"

32. N. Frischauer: "The Aga Khans"

33. M. Kabir: "The Buwayhid Dynasty of Baghdad"

34 "Sikh Religion"

PËRMBAJTJA:

<i>KUSH JANË SHIINJTË?</i>	<i>3</i>
<i>SHIINJTË DHE BOSNJA</i>	<i>16</i>
<i>ÇORODITJET GJATË HISTORISË ISLAME</i>	<i>21</i>
<i>HISTORIA DHE DOGMA E SHIIZMIT</i>	<i>50</i>
<i>ÇKA NA PRET NEVE?</i>	<i>112</i>
<i>LITERATURA MBI SHIIZMIN</i>	<i>136</i>
<i>PËRMBAJTJA:</i>	<i>137</i>